

ANALIZË GJITHËPËRFSHIRËSE E SEKTORIT TË TIK-UT NË KOSOVË

Ndryshimet në eko-sistemin e TIK-ut që nga miratimi i Strategjisë së TI-së

RAPORT HULUMTUES NGA INSTITUTI PËR EKONOMI TË TREGUT TË LIRË (IETL)



Instituti Për Ekonomi Të Tregut Të Lirë

RRETH IETL

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) është organizatë e pavarur, jopartiake dhe jofitimprurëse e themeluar nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), me seli në Prishtinë. Në përmbushjen e misionit të saj, Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë zhvillon hulumtime të besueshme me fokus në temat kryesore ekonomike në sektorin privat në Kosovë dhe i shfrytëzon rezultatet e hulumtimit për avokim, diskutim e debate publike për të ndikuar në krijimin e politikave më të mira për sektorin privat.

Deklaratë mohimi:

Zhvillimi dhe botimi i këtij dokumenti është mbështetur nga projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) Enhancing Youth Employment (EYE), i implementuar nga Helvetas dhe MDA. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësia e vetme e Institutit për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) dhe nuk paraqet domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC, Helvetas, apo MDA.

Të drejtat e autorit:**Hulumtim nga:**

Besa Zogaj Gashi
Hamit Qeriqi
Niklaus Waldvogel
Dr Shawn Cunningham

Përkthimi:

Kushtrim Osmani

Dizajni dhe faqosja:

Norë Potera

Versioni original i shkruar në anglisht.**Publikuar nga:**

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL), me mbështetjen e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK)

Personi Kontaktues:

Znj. Besa Zogaj Gashi
Drejtoreshë Ekzekutive, Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL)

Të drejtat e autorit ©2020 nga Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në ndonjë sistem për ripërdorim, apo të transmetohet në çfarëdo forme përmes çfarëdo mjeti, mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga publikuesi. Për kërkesa të tilla kontaktoni zyrën administrative të Institutit për Ekonomi të Tregut të Lirë.

Përmbajtja

Falenderime	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
1. Sfondi dhe qasja e studimit	7
2. Përgatitja deri te Strategjia e Kosovës për TI	10
2.1 Përgatitja deri te Strategjia e Kosovës për TI	10
2.2 Strategjia e Kosovës për TI	11
2.3 Drejtimi dhe Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Kosovës për TI	11
2.4 Diskutimi i Kapitullit	12
3. Dëshmitë për Zbatimin e Strategjisë së Kosovës për TI	13
3.1 Aktivitetet që burojnë nga Strategjia e Kosovës për TI	13
3.1.1 Themelimi i Ministrisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	13
3.1.2 Tatimet, nxitjet dhe TVSH, Tatimi në të Ardhura	14
3.1.3 TechPark Prishtina	15
3.1.4 Promovimi (ekspozitat, konferencat dhe ngjarjet)	15
3.2 Strategjitë e tjera kombëtare që e plotësojnë sektorin e TIK-ut	15
3.3 Rishikimi i pritur i Strategjisë Kombëtare për TI-në	16
3.4 Diskutimi i Kapitullit	16
4. Peizazhi i TIK-ut në Kosovë	17
4.1.1 Organizatat rregulluese dhe përcaktuese të politikave që e çojnë përpara përmirësimin e sektorit të TIK-ut	17
4.1.2 Organizatat që e promovojnë dhe zhvillojnë drejtpërdrejt sektorin e TIK-ut në Kosovë	19
4.1.3 Institucionet e Arsimit të Lartë	20
4.1.4 Organizatat që e promovojnë dhe zhvillojnë indirekt sektorin e TIK-ut në Kosovë	20
4.1.5 Peizazhi i ndërmarrjeve në sektorin e TIK-ut në Kosovë	21
4.2 Diskutimi i Kapitullit	21
5. Dëshmia e matjes së vazhdueshme të TIK-ut në Kosovë	22
5.1 Monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë për TIK-un	22
5.2 TIK-u në statistikat zyrtare	23
5.2.1 Barometri i Industrisë së TI-së i SEE 2014	23
5.2.2 Barometri i TI-së në Kosovë	23
5.2.3 Anketa për përdorimin e TIK-ut në Kosovë	24

5.2.4 Të dhënat e Eurostat	24
5.2.5 Statistikat e publikuara nga Open Data Kosovo	24
5.3 Mbështetja ndërkombëtare dhe projektet	25
5.4 Studimet e fizibilitetit dhe studimet e donatorëve për dizajnimin e projekteve	25
Mbështetja e BE-së në sektorin e TIK-ut	25
KODE	26
Parku Inovativ dhe Trajnues Kosovë-Gjermani (ITP)	26
5.5 Diskutimi i Kapitullit	26
6. Vlerësimi i performancës së sektorit të TIK-ut në bazë të dëshmive ekzistuese	28
6.1 Promovimi i TIK-ut	28
6.2 Infrastruktura për rrjetet dhe shërbimet e TIK-ut	28
6.3 Shpenzimet e qeverisë	29
6.4 Importimi dhe eksportimi i shërbimeve të TIK-ut	29
6.5 Importimi i pajisjeve të TIK-ut	32
6.6 Trendët e punësimit	32
6.7 Numri i kompanive të TIK-ut në Kosovë	33
6.8 Diskutimi i Kapitullit	34
7. Rekomandimet	35
Shtojca	37
Shtojca 1: Projektet e donatorëve në mbështetje të TIK-ut në Kosovë	37

Lista e figurave

Figura 1: Një përshkrim i qeverisjes aktuale të sektorit të TIK-ut	17
Figura 2: Katër nivelet e sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë së Kosovës për TI-në	22
Figura 3: Përqindja e kompanive kosovare që eksportojnë shërbime të TIK-ut	30
Figura 4: Importimi dhe eksportimi i shërbimeve të TIK-ut	30
Figura 5: Eksportimi i shërbimeve të TIK-ut sipas nën-sektorëve	31
Figura 6: Importimi kundër eksportimit të shërbimeve të TIK-ut	32
Figura 7. Punëtorët në sektorin e TIK-ut	33

Lista e tabelave

Tabela 1: Përkufizimi i industrisë së TI-së në bazë të OETI: 3 klasifikime	7
Tabela 2: Shpenzimet e qeverisë për TIK (2016-2018) në euro	29
Tabela 3: Importimi i pajisjeve të TIK-ut nga viti 2015 deri në shtator të vitit 2019	32
Tabela 4: Bizneset e TIK-ut të regjistruara në Kosovë	33
Tabela 5: Lista e projekteve nga Platforma për Menaxhimin e Ndihmës	37
Tabela 6: Lista e projekteve nga burime të tjera	39

Lista e shkurtesave

ASHI - Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
KPB - Kontraktim i Procesit të Biznesit
BQK - Banka Qendrore e Kosovës
CeBIT - Qendra për Automatizim të Zyrës, Teknologji Informative dhe Telekomunikime
KPPPE - Krijimi i punësimit përmes promovimit të eksportit
PRE - Programi i Reformës Ekonomike
BE - Bashkimi Evropian
GIZ - Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GIZ - The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
QK - Qeveria e Kosovës
QIK - Qendra Inovative e Kosovës
TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar
TI - Teknologjia Informative
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
KIESA - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
IKAP - Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KODE - Ekonomia Digjitale e Kosovës
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
MZHE - Ministria për Zhvillim Ekonomik
MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH/SISH - Ministria e Shëndetësisë/Departamenti i Sistemit të Informacioneve Shëndetësore
MIN - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MIN - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MINT - Matematikë, Informatikë, Shkenca Natyrore dhe Teknologji
MAP - Ministria e Administratës Publike
MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
SKZH - Strategjia Kombëtare për Zhvillim
MPJN - Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë
PTK - Post Telekomunikacioni i Kosovës, Shoqëri Aksionare
RAPEC - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
RKS - Republika e Kosovës
SDC - Bashkëpunimi Zvicëran për Zhvillim
SIPPO - Programi Zvicëran për Promovimin e Importit
NVM - Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
STIKK - Shoqata e Teknologjisë Informative dhe e Komunikimit të Kosovës
USAID - Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
VALA - Telefoni Mobile
TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ATP - Arsim dhe Trajnim Profesional
BB - Banka Botërore
MBP - Mësimi i Bazuar në Punë

Falenderime

Ky raport nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen financiare të Projektit të Agjencisë Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) Enhancing Youth Employment (EYE), i cili implementohet nga Helvetas dhe MDA. Projekti EYE e ka mbështetur Hamit Qeriqin, Shef i Divizionit në (MDA) dhe Niklaus Waldvogel, Menaxher i Intervenimit në EYE. Projekti EYE po ashtu këtë hulumtim e ka mbështetur duke e kontraktuar një ekspert ndërkombëtar, Dr.Shawn Cunningham nga Mesopartner, për të udhëhequr procesin dhe përmbajtjen e hulumtimit.

Instituti IETL falënderon Drejtorin e Departamentit të TIK-ut në MZHE. z. Agim Kukaj për bashkëpunimin e ngushtë gjatë procesit të hulumtimit duke ofruar dokumente të politikave dhe strategjive si dhe informacioneve relevante për sektorin. Në fund një falënderim për përfaqësuesit e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GIZ-CETEP, Shoqatën për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (STIKK) dhe Qendrën Inovative e Kosovës (ICK) për intervistat dhe tre recensentët anonim për komentet e tyre.

Përmbledhje Ekzekutive

Rëndësia e sektorit të Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit (TIK-ut) në Kosovë është një temë që diskutohet shpesh në Kosovë. TIK shihet si një sektor atraktiv për rritje ekonomike, promovimin e eksportit, një sektor kritik për të krijuar vende pune për rininë, kthimin e të rinjve nga diaspora dhe për të mbajtur talentet e rinj në Kosovë.

Ky studim ka gjetur se Qeveria e Kosovës (QeK) e ka nisur një proces të hartimit dhe zhvillimit të një strategjie ambicioze të sektorit të Teknologjisë Informative (TI) gjatë shtatë viteve të fundit. Ndërsa procesi i zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë më shumë është mbështetur nga partnerë të ndryshëm ndërkombëtar. Një grup i vogël i mbështetësve lokal të TIK-ut janë dëshmuar si akterë qendror në pjesët e strategjisë që janë zbatuar me sukses.

Të dhëna të besueshme për performancën dhe ndryshimet në sektorin e TIK-ut në sekuencë kohore vazhdojnë të jenë vështirë për t'u gjetur. Përmes përpjekjeve të STIKK, Barometri i TI-së përqendrohet në vështrimin e përgjithshëm mbi zhvillimin e sektorit të TI-së. Mirëpo, ky është vetëm një dimension i sektorit të TIK-ut. Të dhënat për punësimin, të diplomuarit, migrimin jashtë vendit, investimet dhe prokurimin nuk janë të besueshme. Shumë prej këtyre mangësive mbase janë rezultat i vështirësive nga mospasja e një përkufizimi të qëndrueshëm të TIK-ut në Kosovë.

Sidoqoftë, ekzistojnë studime hulumtuese jo të shpeshta të zhvilluara nga donatorët gjatë procesit të dizajnit të programeve të tyre. Në mënyrë tipike, këto projekte kërkojnë një analizë apo analizë të kostos-përfitimit, dhe kur këto dokumente janë të qasshme për publikun; ofrojnë një pamje më të thellë në çështjet kritike të cilat e kufizojnë këtë sektor. Prapë se prapë, këto analiza shpesh nuk janë gjithëpërfshirëse sa duhet për të krijuar një pasqyrë të përgjithshme të dinamikës së sektorit.

Kur angazhohen akter të ndryshëm, një grup i vogël i individëve dhe organizatave dëshmojnë si kampion të formalizimit të sektorit TIK-ut. Departamenti i TIK-ut i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ka luajtur një rol qendror në mobilizimin e akterëve, çuarjen para të projekteve, ngritjen e vetëdijes dhe sigurimin e mbështetjes

nga donatorët. Sidoqoftë, mbështetja e sektorit të TIK-ut nuk ishte e njëjtë nga e tërë qeveria dhe sukseset e arritura në këtë sektor nuk janë rezultat i politikave dhe masave qeveritare. Pati përsëritje dhe fragmentim të përgjegjësive. Përkundër këtyre kritikave, lista e departamenteve dhe programeve të sektorit publik të përfshira në promovimin e TIK-ut është rritur por, nuk është përhapur ende në tërë qeverinë.

Ne kemi gjetur se shumë prej aktiviteteve të Strategjisë për TI janë zbatuar me sukses por, jo në mënyrë të koordinuar. Hisedarët, si STIKK, kryesisht ka zbatuar aktivitetet që ishin në linjë me interesat e anëtarëve dhe burimeve të tyre të financimit. Shumë aktiviteteve në strategji nuk iu është dhënë kurrë financimi i paraparë në strategji dhe mekanizmat për koordinim dhe matje të dizajnuara në strategji nuk janë përcjellë fare.

Nga ajo që kemi mundur të përfundojmë, dialogu dhe shpërndarja e informatave në mes të sektorit publik dhe atij privat si dhe sektorit të arsimit mund të kishin qenë të mira gjatë fazës së zbatimit të strategjisë. Për më tepër, në kuadër të këtyre grupeve hisedare përkatëse, edhe dialogu ishte i pamjaftueshëm. Përpjekjet për të shfrytëzuar shpenzimet e prokurimit nga sektori publik për të zhvilluar sektorin vendor të TIK-ut ishin të kota. Rezultati ishte se përparimi shpesh u arrit vetëm falë përpjekjeve të individëve apo grupeve të vogla të njerëzve.

Është e vështirë të thuhet se ku do të ishte sektori i TIK-ut pa mbështetjen e donatorëve! Gjatë intervistave, donatorët na thanë se ata duhet të tregoheshin vazhdimisht të kujdesshëm për të plotësuar përpjekjet vendore dhe për të mos e marrë përsipër koordinimin e sektorit. Në intervistat me zyrtarët qeveritar e pranojnë rolin kritik të donatorëve por, po ashtu pohojnë se ka pasur nevojë për më shumë mbështetje. Projektet e reja të donatorëve i janë referuar gjithmonë Strategjisë për TI për orientimin e tyre. Sidoqoftë, nuk është e qartë nëse Qeveria e Kosovës e ka pasur gjithmonë fuqinë në ujdin për të formësuar prioritetet dhe mekanizmat e zgjedhur nga donatorët. Prapë se prapë, pa këtë mbështetje, do të duhej shumë më tepër kohë që të zhvilloheshin institucionet kritike, programet e shkathtësive dhe investimet, apo

ndoshta nuk do të zhvilloheshin fare vetëm me burimet dhe kompetencat vendore.

Sfida në të ardhmen do të jetë përmirësimi i përpjekjeve të sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile për të adresuar çështjet kritike. Thelbësore për këtë do të ishte përmirësimi i vazhdimësisë dhe saktësisë së të dhënave të cilat vendimmarrësit mund t'i përdorin për t'i formësuar programet, investimet dhe përpjekjet e tyre.

1. Sfondi dhe qasja e studimit

Ky studim u bë i mundshëm nga ndërthurja e disa rrethanave. E para është refreni i vazhdueshëm në shumë qarqe të zhvillimit ekonomik për rëndësinë dhe potencialin e sektorit të TIK-ut në Kosovë. Kjo shpesh kombinohet me rininë si grup moshë më e madhe e popullsisë në vend, migrimin jashtë vendit të rinjve dhe rëndësinë e rritjes së një ekonomie moderne dhe të orientuar nga e ardhmja dhe kërkesave të tregut..

Sektori i TIK-ut vlerësohet të jetë një sektor kyç ekonomik në Kosovë mirëpo, aktualisht, nuk ka një pamje të qartë të shëndetit të ekosistemit të TIK-ut. Dëshmitë jo formale sugjerojnë se sektori është duke u rritur në mënyrë të rrufeshme dhe se konkurrenca e sektorit të TIK-ut në Kosovë mund të arrijë atë të vendeve fqinje. Sidoqoftë, të dhënat zyrtare shpesh janë kundërthënëse dhe jo të besueshme.

TIK-u mund të shihet si sektor por edhe si teknologji e përdorur në ekonomi. Po çka nënkupton saktësisht TIK-u në Kosovë? A ka të bëjë kryesisht me sektorin, i cili përfshinë ekskluzivisht sektorin privat, disa klient nga sektori

publik, klientë ndërkombëtar dhe organizatat vendore arsimore apo mbështetëse? Apo ndoshta ka të bëjë me shfrytëzimin e TIK-ut në tërë ekonominë? Një arkitekt i cili e përdor një softuer modelues dhe një printer 3D, është pjesë e sektorit të TIK-ut, apo një arkitekt që e përdor TIK-un?

Fokus kryesor i këtij raporti është që të shqyrtojë përparimin e arritur pas miratimit të Strategjisë së Kosovës të TI. Sidoqoftë, disa vështirësi paraqiten për shkak se shumë hisedarë e përdorin TI-në dhe TIK-un në mënyrë të ndërsjellë. Kurse, herë të tjera fraza sektori i TIK-ut zëvendësohet për përdorimin dhe aplikimin e teknologjive të TIK-ut në ekonomi.

Përkufizimi i sektorit të TIK-ut

Në Strategjinë e Kosovës për TI, një përkufizim i industrisë së TI-së është dhënë për atë që citohet gjerësisht në klasifikimin e Observatorit Evropian të Teknologjisë Informative (OETI)¹. Tabela 1 jep një pasqyrë të klasifikimit të industrisë së TI-së sipas OETI: 3

Tabela 1: Përkufizimi i industrisë së TI-së në bazë të OETI: 3 klasifikime

Segmentet e tregu të TI-së	Nën-segmentet
Softueri	Infrastruktura e Sistemit Zhvillimi dhe shpërndarja (Zh&Sh) e aplikacionit softuerik Aplikacionet
Shërbimet e TI-së	Projektet Kontraktimi (me përjashtim të KPB) Mbështetja dhe shpërndarja Shërbimet e KPB (përfshirë konsulencën për biznese)
Pajisjet e TI-së	Serverët, Hapësira për ruajtjen e të dhënave, Stacionet e punës, Kompjuterët, Kompjuterët Portativë, Netbukat, Kompjuterët Portativ për Konsumatorë, Kompjuterët Portativ për Biznes, Kompjuterët Desktop, Kompjuterët Desktop për Konsumatorë, Kompjuterët Desktop për Biznese, Tabletët e Mediave, Printerët me shumë funksione, pajisje të tjera të IT-së.

Fokusi i Strategjisë së Kosovës për TI është në softuerë dhe shërbime të TI-së siç është përkufizuar në Tabela 1 më sipër.

Një përkufizim tjetër shumë i përdorur është dhënë nga Banka Botërore në Treguesit e Zhvillimit Botëror (TZhB) - një bazë e të dhënave e cila

i përcjellë treguesit e ndryshëm zhvillimor. Në bashkësinë e të dhënave të TZhB-së, të dhënat për eksportin dhe importin e mallrave dhe shërbimeve të TIK-ut të marra nga Statistikat e Bilancit të Pagesave të Fondit Monetar Ndër-

¹Përkufizime të tjera të cituara shpesh janë dhënë nga Rishikimi ISIC 4 ose klasifikimet e UNSPSC.

kombëtar (FMN). "Doracaku i bilancit të pagesave dhe pozitës së investimit ndërkombëtar" i FMN-së, e klasifikon dhe përkufizon TIK-un si në vijim:

Shërbimet e telekomunikimit - e përfshijnë transmetimin e zërit, pamjeve, të dhënave apo informatave të tjera përmes telefonit, teleksit, transmetimit kabllor në radio dhe televizion, radio-televizionit satelitor, postës elektronike, faksimilit, e kështu me radhë duke i përfshirë shërbimet e rrjetit të biznesit, telekonferencave, dhe shërbimeve mbështetëse. Ato nuk e përfshijnë vlerën e informacionit të transportuar. Po ashtu janë të përfshira edhe shërbimet e telekomunikacionit, shërbimet e "backbone" të internetit, dhe shërbimet e qasjes online, duke e përfshirë ofrimin e qasjes në internet. Janë të përjashtuara shërbimet e instalimit të pajisjeve për rrjetin telefonik (të përfshira në ndërtim) dhe shërbimet e bazave të dhënave (të përfshira në shërbimet e informimit).

Shërbimet kompjuterike - përbëhen nga shërbimet që kanë të bëjnë me harduer dhe softuer dhe shërbimet për përpunimin e të dhënave. Shërbimet për kompjuterë përfshijnë:

- shitjen e softuerëve të personalizuar (sido që të dorëzohen) dhe licencat përkatëse për përdorim;
- zhvillimin, prodhimin, furnizimin, dhe dokumentimin e softuerëve të personalizuar, duke i përfshirë sistemet operative, të punuara sipas porosive për përdorues specifik;
- softuerët e jo personalizuar (të prodhuara në masë) të shkarkuara apo të dorëzuara elektronikisht në mënyrë tjetër, qoftë për një tarifë licencimi periodike apo me një pagesë të vetme;
- licencat për përdorimin e softuerëve të jo personalizuar (të prodhuara në masë) që ofrohen në një pajisje për ruajtje si një disk apo cd-rom me një tarifë licencimi periodike (softueri i jo personalizuar në pajisje për ruajtje me licenca që e lejojnë përdorimin e përhershëm është i përfshirë në shitjen e mallrave dhe blerjen e origjinaleve dhe të drejtave të pronësisë për sistemet dhe aplikacionet e softuerëve.
- shërbimet e konsulencës dhe zbatimit për harduer dhe softuer, duke e përfshirë menaxhimin e shërbimeve kompjuterike të nënkontraktuara;
- instalimi i harduerit dhe softuerit, duke përfshirë kompjuterët mainframe dhe njësitë qendrore kompjuterike;
- mirëmbajtja dhe riparimet e kompjuterëve

dhe pajisjeve periferike;

- shërbimet për shpëtimin e të dhënave; ofrimi i këshillave dhe ndihmës për çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve kompjuterike;
- analizimi, dizajnimi dhe programimi i sistemeve të gatshme për përdorim (duke e përfshirë zhvillimin dhe dizajnimin e ueb faqeve), dhe konsulenca teknike në lidhje me softuerët;
- mirëmbajtja e sistemeve dhe shërbimet e tjera mbështetëse, si trajnimi i ofruar si pjesë e konsulencës;
- procesimi i të dhënave dhe shërbimet e hosting, siç janë futja e të dhënave, tabelimi dhe procesimi në bazë të timesharing (përdorimit të njëkohësishëm)
- shërbimet e hosting për ueb faqe (p.sh. ofrimi i hapësirës për server në internet për ueb faqet e klientëve të hostingut); dhe
- (ofrimi i aplikacioneve, hosting për aplikacionet e klientëve dhe menaxhimin për objektet kompjuterike

Softueri përfshinë softuere për produktivitetin e përgjithshëm të biznesit, softuere për lojëra kompjuterike dhe aplikacionet e tjera. Sidoqoftë, disa forma të softuerëve janë të klasifikuara si mallra. Mund të jetë e dobishme në aspektin analitik sikur të mund të identifikonim të gjitha softuerët qoftë si mallra apo shërbime. Koha e regjistrimit të shërbimeve softuerike i ndjek parimet e njëjta sikurse për pronat e tjera intelektuale, të identifikuar në paragraf. Kurset e trajnimeve kompjuterike jo të dizajnuara për përdorues specifik janë të përjashtuara nga shërbimet kompjuterike (janë të përfshira në shërbimet e tjera personale, kulturore dhe rekreative). Pagesat për licencat për të riprodhuar apo shpërndarë softuere (apo të që të dyja) të cilat janë të përfshira në pagesat për shfrytëzimin e pronës intelektuale, po ashtu janë të përjashtuara. Lizingu i kompjuterëve pa një operator është i përfshirë në lizingun operacionial.

Shërbimet informuese - përfshijnë shërbimet e agjencive të lajmeve, si ofrimi i lajmeve, fotografive, dhe artikujve në media. Shërbimet e tjera që ofrojnë informacione - konceptimi i bazave të të dhënave, ruajtja e të dhënave dhe shpërndarja e të dhënave dhe bazave të të dhënave (duke i përfshirë drejtoritë dhe listat e postimit), si online edhe përmes mediave magnetike, optike apo të shtypura; dhe portalet për kërkim në internet (shërbimet e motorëve kërkues të cilat i gjejnë adresat në internet për

klientët të cilët i fusin kërkimet me fjalët kyçe). Gjithashtu, janë të përfshira edhe abonimet direkte jo me shumicë në gazeta dhe revista, qoftë përmes postës, transmetimit elektronik, apo metodave të tjera; shërbimet e tjera ofruese të përmbajtjes online, shërbimet e librarive dhe arkivave. Përmbajtja e shkarkuar që nuk është softuer (e përfshirë në shërbimet kompjuterike) apo audio dhe video (e përfshirë në shërbimet audio vizuale dhe të ndërlidhura) është e përfshirë në shërbimet informuese².

Banka Qendrore e Kosovës e përdor përku-fizimin dhe metodologjinë e FMN-së për rapor-timin e të dhënave për bilancin e pagesave³.

Qasja e Studimit

Në këtë studim, ne jemi bazuar në raporte zyrtare dhe të dhëna të qasshme për publikun si dhe në informacionin e mbledhur gjatë intervistave cilësore me hisedarët kryesor. Studimi fillon me vlerësimin origjinal të Sektorit të TIK-ut i cili është zhvilluar gjatë periudhës 2013-2014. Pastaj shkurtimisht diskutojmë për strategjinë dhe veprimet e propozuara që kanë rezultuar nga Strategjia e Kosovës për TI.

Për ta kuptuar më mirë se si ka ndryshuar ekosistemi përreth sektorit të TIK-ut që nga aprovimi i Strategjisë për TI në 30 Dhjetor të vitit 2015 ne kemi kërkuar dëshmi për monitorimin, koordinimin dhe reflektimin e vazhdueshëm të strategjisë. Ne e kemi hulumtuar se në çfarë të dhëna ishin të bazuara vendimet e politikave, dhe çfarë studimesh shtesë janë zhvilluar që nga strategjia. Ne i intervistuam hisedarët e industrisë për të kuptuar më mirë se si sektori ka ndryshuar dhe çfarë roli kanë luajtur organizatat e ndryshme.

Për të kuptuar më mirë gjendjen aktuale të sektorit të TIK-ut, ne i kemi analizuar edhe të dhënat në dispozicion të publikut.

Studimin e përfundojmë më disa rekomandime të nivelit të lartë.

²Balance Of Payments And International Investment Position Manual — Washington, D.C.: International Monetary Fund, 2009.

³Balance of Payments and International Investment Position Methodology, CBK, 2015. <https://www.bqk-kos.org/repository/docs/BOP%20and%20I-P%20Methodology.pdf>

2. Përgatitjet deri te Strategjia e Kosovës për TI

Ky kapitull e ofron një pasqyrë të përgatitjes dhe formulimit të Strategjisë e Kosovës për TI, i cili ka qenë dokumenti kyç për shumicën e zhvillimeve dhe vendimeve strategjike në këtë sektor që nga miratimi i tij nga qeveria në Dhjetor të vitit 2015. Ndërsa dëshmitë e zbatimit të strategjisë do të diskutohen në Kapitullin 3.

2.1 Përgatitjet deri te Strategjia e Kosovës për TI

Një sërë ligjesh dhe politikash me zanafillë që nga fillimi i viteve 2000 i kanë paraprirë Strategjisë së Kosovës për TI-së. Këtu, për shembull, përfshihen:

- Ligji për Telekomunikacionin - i miratuar në vitin 2002
- Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike - i miratuar në vitin 2005, i ndryshuar në vitin 2012
- Ligji për Procedurën Administrative
- Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta - i miratuar në vitin 2004
- Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore - i miratuar në vitin 2004
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik
- Ligji për Privatësinë dhe Qasjen në Baza të të Dhënave
- Ligji për Shërbimet Postare
- Ligji për Komunikimet Elektronike

Korniza punuese strategjike në vijim i ka vendosur themelet e strategjisë për TI:

- "eSEE Agjenda Plus për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në EJK 2007-2012". Kosova ishte anëtare aktive e Nismës eSEE rajonale - (Evropa Jug-Lindore Elektronike). Objektivi kryesor i nismës ishte integrimi i vendeve të EJK në ekonominë globale të bazuar në dituri përmes zhvillimit të Shoqërisë së Informacionit, në linjë me kornizën e BE-së 2010. Nisma eSEE u krijua nga Pakti i Stabilitetit dhe tani përcillet nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal nisma për Integrimin Digjital e Ballkanit Perëndimor (WB6).
- Strategjia Kombëtare për Shoqëri Informative 2006-2012 - Strategjia është miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2006.
- Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2009-2015 - E publikuar nga Departamenti për Teknologji Informative e Ministrisë së Shërbimeve Publike të Kosovës në vitin 2008, që e ka siguruar ofrimin

e shërbimeve të institucioneve qeveritare përmes teknologjisë informative dhe të komunikimit (WAN-it, internetit, rrjetit mobil) për qytetarët, bizneset dhe të tjerët.

- Strategjia për Mësim Elektronik e Kosovës 2010-2015 - e përgatitur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me objektivin kryesor që të transformohet të mësuarit elektronik në një pjesë integrale të sistemit arsimor mbarë-kombëtar.

- Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Para Universitar 2007-2017 - e miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e shfrytëzuar si bazë për zhvillimin e sistemit arsimor në Kosovë.

- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016 - i hartuar në Shtator të vitit 2010, ky Plan Strategjik i cili ka përfshirë tetë programe me prioritet në mesin e të cilëve janë Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Teknologjia Informative dhe e Komunikimit.

- Politikat e sektorit të Komunikimeve Elektronike - Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020. Prioritetet kryesore të Agjendës Digjitale janë zgjerimi i Infrastrukturës Broadband, zhvillimin e Shërbimeve Online dhe përmirësimin e Shkathtësive Digjitale.

Analiza e GIZ-it e Industrisë së TI-së në Kosovë e vitit 2013

Në fillim të vitit 2013, Qeveria e Kosovës (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MZHE) dhe Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) e theksuan rëndësinë strategjike të sektorit të TIK-ut dhe i kërkuan Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) që të mbështeste zhvillimin e industrisë të TI-së (Raporti Vlerësues: Analizë e Industrisë së TI-së në Kosovë, Maj 2013 (GIZ). Asokohe sektori ishte shumë i fragmentuar dhe jo mirë i organizuar. GIZ më pas e bëri një analizë të detajuar të ekosistemit në kuadër të projektit të tyre "Promovimi i Konkurrencës së Sektorit Privat në Kosovë", për të cilën GIZ e shfrytëzoi një metodë të vetë-zhvilluar të quajtur "Promovimi i Sektorit të IT-së në Vendet në Zhvillim". Kjo metodë shkon në detaje ekstreme dhe e mundëson analizimin e "shëndetit" të sektorit të TIK-ut në shumë aspekte (të brendshme dhe të jashtme).

Analiza e brendshme e synoi vlerësimin e

"strukturave, burimeve dhe aftësive të industrisë së TI-së" dhe për të zhvilluar këtë analizë u përdor i ashtuquajtur "Model i Aftësive të Industrisë së TI-së (ITICM)". Analiza e Brendshme i shikon strukturat, burimet dhe aftësitë e industrisë së TI-së përgjatë 9 (nëntë) "dimensioneve të aftësive": institucionet shtetërore, infrastrukturën e TIK-ut, kërkesën, karakteristikat strukturore të industrisë, aftësitë e kompanive, institucionet akademike dhe mbështetëse, lidhjet dhe brendet ndërkombëtare, inovacioni dhe ndërmarrësia dhe aftësitë dinamike. Këto dimensione i kanë shikuar nivelet e ndryshme sistemike (makro, meso dhe mikro) dhe përbëhen nga një sërë "Faktorësh të Aftësive". Për të zhvilluar **analizën e jashtme**, u analizuan kapacitetet kyçe të tregut të eksportit, madhësia dhe trendet (tregjet në Gjermani, Austri, Zvicër, Norvegji, Mbretëri të Bashkuar dhe Holandë). Rezultatet e këtij vlerësimi u publikuan në Maj të vitit 2013, në raportin "Analizë e Industrisë së TI-së në Kosovë". Gjetjet e këtij raporti tregojnë se "industria e TI-së në Kosovë ka potencial domethënës për rritje dhe mund të jap kontribut të çmuar në rritjen e konkurrencës së Kosovës në nivel ndërkombëtar dhe në promovimin e zhvillimit ekonomik. Sidoqoftë, potenciali për rritje të industrisë së TI-së në Kosovë ishte tejet i kufizuar nga një sërë sfidash dhe pengesash strukturore si:

- mungesa e strukturave dhe programeve përkatëse mbështetëse,
- mangësive të theksuara në fushën e arsimit dhe trajnimit teknik,
- kompanitë e përmasave të vogla (struktura e NVM),
- largimi i trurit,
- tregu i vogël dhe i pazhvilluar vendor,
- mungesa e aftësive të eksportit dhe marketingut ndërkombëtar,
- mungesa e markave dhe lidhjeve ndërkombëtare dhe mungesa e strategjisë dhe politikave kombëtare për TI⁴.

Hapi i radhës ishte formulimi i Strategjisë së Kosovës për TI.

2.2 Strategjia e Kosovës për TI

Sipas përfaqësuesve të GIZ-it dhe STIKK-ut, ideja origjinale ishte që kjo analizë të shfrytëzohej për të zhvilluar një strategji të TI-së për sektorin privat. Sidoqoftë, MZHE e propozoi zgjerimin e

⁴Assessment Report- Analysis of the Kosovo IT Industry, Capgemini Consulting, 2013.

saj për të krijuar një strategji kombëtare për TI⁵. Me mbështetjen e GIZ-it, u përdor një metodologji për zhvillimin e strategjisë në mënyrë që të sigurohej një qasje e integruar për promovimin e sektorit të TI-së⁶. Gjatë formulimit të strategjisë u organizuan mbi 10 punëtori, një proces që u udhëhoq nga një konsulent i GIZ-it.⁷

Strategjia shkoi në detaje ekstreme në raport me: detyrat, buxhetin dhe afatin kohor si dhe ndarjen e përgjegjësive në mes të një vargu të hisedarëve të ndryshëm. Buxheti i tërësishëm që nevojitej për zbatimin e plotë ishte rreth 15 milionë EUR, i cili është i shpërndarë në mes të një sërë burimesh si Qeveria e Kosovës (ministritë e ndryshme), agjencitë donatore: Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), Bashkimi Evropian (BE), Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SDC), Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (MPJN) dhe të tjerë, ndërsa dhe afati kohor për aktivitete shtrihej nga fillimi i vitit 2014 deri në fund të vitit 2017.

Strategjia e Kosovës për TI u dorëzua Qeverisë së Kosovës në Prill të vitit 2015 dhe u miratua më 30 Dhjetor të po atij viti.

Në mënyrë që të ofrohej koordinim dhe zbatim sa më i mirë i masave strategjike, strategjia për TIK-un u nda në nëntë shtyllat strategjike në vijim:

1. Politikat e Promovimit të TI-së
2. Cilësia e Kompanive
3. Promovimi i Eksportit
4. Zhvillimi i Tregut Vendor
5. Arsimimi në TI
6. Grupimet dhe Bashkëpunimet në TI
7. Ndërmarrësia
8. Inovacioni dhe Aplikimi i Kërkimit e Zhvillimit
9. Promovimi i Investimeve

2.3 Drejtimi dhe Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Kosovës për TI

Strategjia e TI-në ishte e qartë për sa i përket koordinimit dhe monitorimit të zbatimit të strategjisë. Sidoqoftë, disa prej të intervistuarve kanë raportuar se pas disa takimeve koordinimi ka gëcur.

⁵http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_IT_Strategy.pdf

⁶GIZ (2011): Manual for IT Sector Promotion in Developing and Emerging Countries.

⁷<http://groups.itu.int/LinkClick.aspx?fileticket=HLju6vFJJ5o%3D&tabid=1862>

⁷Lucas Von Zallinger

Si një element i sistemit monitorues, Barometri i STIKK-ut (për më shumë detaje shih kapitullin 5.2.2) ka ofruar informacione mbi sektorin. Duhet kujtuar se Barometri i STIKK-ut fillimisht bazohej në një instrument rajonal. Në formën e tij origjinale, ai nuk ishte i dizajnuar për të qenë një barometër për vlerësimin e zbatimit të strategjisë por, më shumë një sistem i matjes për performancën e kompanive të TI-së. Kjo është konfirmuar nga STIKK gjatë njërës prej intervistave. Gjithsesi, ai gjeneron informacion të dobishëm për disa prej nëntë dimensioneve të strategjisë si për shembull kërkesën, karakteristikat strukturore të industrisë, aftësitë e kompanive, lidhjet dhe markat ndërkombëtare.

2.4 Diskutimi i Kapitullit

Leximi i parë i Strategjisë së Kosovës për TI është pothuajse i jashtëzakonshëm. Ky është një dokument gjithëpërfshirës i cili i mbulon nëntë shtylla, me më shumë se 90 “detyra” të detajuara. Këto detyra nuk janë zbatuar as për së afërmi (shih kapitullin e radhës) kryesisht për shkak të burimeve të pamjaftueshme. Nuk është gjithmonë e qartë nëse një detyrë ishte e bazuar në interesat e ndonjërit prej hisedarëve, donatorëve, klientëve apo sektorit të TIK-ut apo në analizën e raportit për industrinë e TI-së i cili i parapriu strategjisë. Gjithashtu, funksioni i koordinimit duket i koklavitur për një rrjet të hisedarëve të cilët sapo kishin filluar që të fitonin besimin e njëri-tjetrit dhe të krijonin përvojë në bashkëpunim.

3. Dëshmitë për Zbatimin e Strategjisë së Kosovës për TI

Në këtë kapitull do të shqyrtojmë dëshmitë e zbatimit të Strategjisë së Kosovës për TI. Ky kapitull nuk e ka për qëllim që të jetë monitorim, vlerësim apo një ushtrim për rishikim. Në fakt, ai fokusohet në dëshmitë që janë në dispozicion në domenin publik, apo informacionet e mbledhura gjatë intervistave dhe takimeve me hisedarët kyç të këtij sektori.

3.1 Aktivitetet që burojnë nga Strategjia e Kosovës për TI

Strategjia për TI e ka përshkruar një kornizë të qartë për bashkëpunimin dhe koordinimin. Disa hisedarë na kanë thënë se janë mbajtur vetëm disa takime koordinuese.

Buxheti po ashtu supozoi se donatorët ndërkombëtar do të financonin zbatimin dhe koordinimin e Strategjisë për TI. Kjo nuk u materializua. Sidoqoftë, ne gjetëm se shumë programe/projekte të reja të dizajnuara nga donatorët në mënyrë eksplicite iu referuan Strategjisë për TI si një pikë kyçe të referimit.

Ishte në dorën e hisedarëve dhe prijësve individual që të zbatonin detyrat që përputheshin më së miri interesat dhe buxhetet e tyre. Aktivitetet e zbatuara në fakt patën një efekt shumë pozitiv në këtë sektor. Aktivitetet për të cilat gjetëm më së shumti dëshmi shtriheshin në shumicën e nëntë shtyllave të Strategjisë së Kosovës për TI.

Nga ana e STIKK-ut "Barometri i Industrisë së TI-së" është zbatuar, është themeluar një akademi trajnuese dhe takimet e Bizneseve më Biznese (B2B) të kompanive kosovare me klientë potencial janë bërë fokus strategjik. Për më tepër, STIKK është duke u angazhuar fuqishëm në diskutimet në mes të tjerash për lëndët e Matematikës, Informatikës, Shkencave Natyrore dhe Teknologjisë (MINT) në arsimin fillor dhe të mesëm.

Me mbështetjen e komunitetit të donatorëve, janë krijuar lidhje ndërkombëtare me ICK dhe është zgjeruar baza e sponsorizimit. Është themeluar Instituti i AUK-ut për Trajnim dhe Zhvillim si një institucion i bazuar në dituri i cili e përfshinë TIK-un si fokus kryesor. TIK-u është bërë më i dukshëm në sektorin e arsimit profesional përmes akreditimit të disa programeve të

nivelit të 5-të përmes ofruesve të ndryshëm privat të trajnimit. Udhëzimet administrative për të Mësuarit e Bazuar në Punë (MBP), një element i rëndësishëm për arsimin dhe trajnimin profesional (ATP), janë hartuar dhe aktualisht janë duke pritur që të miratohen.

Krahas kësaj, katër nismat në vijim dallohen për përfshirjen e hisedarëve të shumëfishët publik, privat dhe ndërkombëtar.

3.1.1 Themelimi i Ministrisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Shtylla e parë, Politikën e Promovimit të TI-së të Strategjisë së Kosovës për TI-në e specifikon themelimin e një ministrie të dedikuar për TIK-un. Mandati i Ministrisë së TIK-ut do të ishte promovimi i "transformimit digjital të Kosovës", mbështetjes së Kosovës për t'u bërë një ekonomi e bazuar në dituri dhe nxitjen e industrisë së TI-së për t'u bërë shtysa kryesore e rritjes ekonomike, punësimit dhe inovacionit".⁸ Funkcionet themelore për Ministrinë e TIK-ut ishin paraparë që të ishin:

- Transformimi digjital
- Strategjia për TIK-un
- Politikën për TIK-un
- Infrastruktura e TIK-ut
- Promovimi i sektorit të TIK-ut
- Qytetaria digjitale dhe e-qeverisja
- Zhvillimi i aftësive digjitale dhe përsosmërisë së burimeve njerëzore
- Siguria kompjuterike
- Zyrtari kryesor kombëtar për informacion (ZKI) dhe këshillim i qeverisë për TIK
- Inovacioni në TIK
- Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Krahas kësaj, strategjia për TIK-un e kishte paraparë krijimin e Agjencisë Kombëtare për Promovim të TI-së, pasi që Ministria për TIK-un të ishte plotësisht funksionale. U rekomandua që kjo Agjenci të organizohej në formën e një ndërmarrjeje publike apo Partneritetit Publiko Privat (PPP).

Në vitin 2014, STIKK e përgatiti një dokument politikash "Ministria e Inovacionit & Teknologjisë" Zhvillimi i sektorit të teknologjisë dhe inovacionit përmes themelimit të Ministrisë së Inovacionit dhe Teknologjisë". Në këtë dokument deklaroi-

⁸Strategjia e Kosovës për TI.

het se "mungesa e Ministrisë së Teknologjisë dhe Inovacionit është bërë një pengesë për zhvillimin e sektorit të TI-së në Kosovë dhe një pengesë për rritjen e punësimit në këtë sektor, shërbimeve joefikase të administratës. Ministria e Teknologjisë dhe Inovacionit, sipas dokumentit duhet të krijohet nga agjencitë dhe departamentet ekzistuese të TI-së në institucionet e Kosovës, me qëllim të koordinimit të punës së tyre me një mandat dhe përgjegjësi që të mundësojnë shfrytëzimin e potencialit që e ka teknologjia informative si për zhvillimin ekonomik ashtu edhe për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve i cili do të shërbente si një burim potencial, jo vetëm për Kosovën por për tërë rajonin dhe më gjerë, në ofrimin e një sektori më të përparuar të teknologjisë informative.⁹

Në praktikë, një Ministri dhe Agjenci e tillë e TIK-ut nuk u krijuan kurrë, ndonëse STIKK ka lobuar vazhdimisht për themelimin e tyre. Në kuadër të Ministrisë së TIK-ut ishte planifikuar që të bashkoheshin të gjitha departamentet relevante të TIK-ut, e-qeverisjes, shkencës dhe inovacionit nga disa ministri si Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE).

Në vend të krijimit të Ministrisë së TIK-ut, Qeveria e Kosovës (QeK) në vitin 2017 e krijoi Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) me kompetenca për të hartuar, zbatuar, koordinuar dhe mbikëqyrur politikat, strategjitë dhe legjislacionin në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë në emër të Qeverisë së Kosovës. Krahas kësaj, MIN e ka mandatin që të propozojë masa fiskale dhe jo fiskale në funksion të zhvillimit dhe promovimit të sektorëve të inovacionit dhe ndërmarrësisë.

3.1.2 Tatimet, nxitjet dhe TVSH, Tatimi në të Ardura

Tarifat doganore dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për pajisjet e TI-së në Kosovë janë parë si të larta (16%) në krahasim me vendet e tjera nga rajoni si Shqipëria (10%) dhe Maqedonia Veriore (5%). Prandaj, zvogëlimi i tarifave doganore dhe TVSH-së për pajisjet e TI-së ishte një nga ndërhyrjet e planifikuara të strategjisë për TIK-un

⁹Dokumenti i Qëndrimit - Zhvillimi i sektorit të teknologjisë dhe inovacionit përmes krijimit të Ministrisë së Inovacionit dhe Teknologjisë, STIKK, 2014

për të fuqizuar pozitën konkurruese të industrisë kosovare të TI-së. Krahas kësaj, kjo masë ishte e supozuar që të mbështeste promovimin e përdorimit të TIK-ut në Kosovë, duke e bërë blerjen e pajisjeve të TI-së më të leverdishme.

Në vitin 2013, STIKK e zhvilloi një analizë socio-ekonomike për ndikimin e tarifës së TVSH-së në pajisjet dhe shërbimet e TIK-ut në Kosovë. Në mes të tjerash, kjo analizë e rekomandoi "futjen e një tarife fikse të TVSH-së prej 5% (zbritje nga 16%) të zbatueshme për pajisjet e TIK-ut (harduer dhe softuer) dhe për shërbimet e ndërlidhura me TIK-un"¹⁰.

Një numër i aktiviteteve lobuese dhe avokuese, si dhe punëtorive për ndryshimin e politikave tatimore dhe të TVSH-së janë ndërmarrë nga STIKK. Aktivitetet e lobimit ishin të fokusuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Financave dhe tek Anëtarët e Kuvendit e të Kosovës.

Pas dy viteve të suksesshme të avokimit dhe lobimit nga STIKK, dhe përkushtimit të Qeverisë për të trajtuar sektorin e TIK-ut me prioritet, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) e nxori Udhëzimin Administrativ sipas të cilit pajisjet e TIK-ut do të kenë tarifë të reduktuar të TVSH-së prej 8%.

Në vitin 2015, Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, i cili e reduktoi tarifën e TVSH-së (nga 18% në 8%) për një numër të mallrave dhe shërbimeve, në mes të tjerash për pajisjet e teknologjisë informative. Për të zbatuar këtë ligj, QK/MF e miratoi Udhëzimin Administrativ (UA) 03/2015 për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar". Sipas Ligjit për TVSH-në, dhe UA 03/2015 "pajisjet e importuara të TI-së do të përjashtohen nga TVSH. Përjashtimi do të miratohet vetëm për bizneset të cilat zhvillojnë aktivitete në fushën e TI-së dhe importojnë pajisje të reja për qëllime të rishitjes. Për të përfituar nga përjashtimi, biznesi duhet të parashtrojë kërkesë pranë Administratës Tatimore"¹¹.

Sipas një analize të kryer nga Instituti GAP në vitin 2016, "reduktimi i TVSH-së ua mundëson shitësve dhe konsumatorëve të pajisjeve të TI-së që të shesin, gjegjësisht blejnë prodhime të TI-së

¹⁰Zbatimi i tarifave të reduktuara të TVSH-së për disa produkte dhe shërbime të caktuara të TIK-ut - Ndikimi socio-ekonomik për Kosovën, 2013, STIKK.

¹¹Udhëzimi Administrativ Nr.03/2015 për zbatimin e Ligjit Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

me çmime më konkurruese në krahasim me Maqedoninë duke pasur parasysh se TVSH-ja për pajisjet e TI-së në Maqedoni është 5%. Përfaqësuesit e STIKK e kanë kërkuar zgjerimin e listës së prodhimeve me TVSH të reduktuar sepse një numër i prodhimeve të rëndësishme (p.sh. Printerët) nuk janë të përfshirë në këtë listë.

3.1.3 TechPark Prishtina

Më mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, GIZ, BERZH është duke e finalizuar faza e parë e revitalizimit dhe rindërtimit të TechPark Prishtina. Ky projekt është duke u zbatuar nga STIKK dhe synon që t'i ndihmojë bizneset e vogla dhe të mesme si dhe kompanive të sapokrijuara duke ofruar hapësira, shërbime profesionale, infrastrukturë moderne dhe promovim adekuat. Në të njëjtën kohë, TechPark do të ofrojë lidhje dhe sinergji në mes të tregjeve vendore dhe ndërkombëtare, universiteteve dhe institucioneve të tjera mbështetëse.

3.1.4 Promovimi (ekspozitat, konferencat dhe ngjarjet)

KosICT është një Konferencë Rajonale e organizuar nga STIKK në partneritet me ICK dhe Kolegjin Universum, ku çdo vit synon të mbulojë temat e trendëve globale të TIK-ut duke angazhuar folës ndërkombëtar, rajonal dhe vendor. Në vitin e kaluar u organizua edicioni i 8-të i KosICT TECH Festival – Edicioni i 8-të. Gjatë shtatë edicioneve të mëparshme të konferencës, KosICT ishte nikoqir i mbi 5000 pjesëmarrësve nga sektori i TIK-ut, të cilët patën mundësinë që të dëgjonin dhe mësonin nga ekspertët e fushave si Transformimi Digjital, e ardhmja e Kontraktimit në Vende të Afërta/Kontraktimit të Jashtëm, Ndërmarrësisë, Financim nga Turmat, Inovacioni i Hapur, etj.¹²

STIKK, Programi Zviceran për Promovimin e Importit (programi SIPPO), GIZ dhe Ministria e Punëve të Jashtme kanë mbështetur gjithashtu promovimin e industrisë së TIK-ut në Kosovë në Qendrën për Automatizimin e Zyrave, Teknologjinë Informative dhe Telekomunikim” (CeBIT) në Hanover.

3.2 Strategjitë e tjera kombëtare që e plotësojnë sektorin e TIK-ut

Strategjia për TIK-un është pjesë përbërëse e rëndësishme në disa strategji, politika dhe programe të tjera të Qeverisë së Kosovës. Disa strategji janë bazuar në idetë apo çështjet e ngritura në Strategjinë për TI-në. Këtu bëjnë pjesë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021.
- Programi i Reformës Ekonomike (PRE) 2018-2020/2019-2021
- Strategjia e Agjendës Digjitale 2020

Këto tri strategji dhe mënyra se si ato janë bazuar në Strategjinë për TI-në do të shpjegohen shkurt në vijim.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021¹³ bazohet në Strategjinë për TI-në dhe këmbëngul se Teknologjia për Informim dhe Komunikim (TIK) është e rëndësishme për proceset e bizneseve, institucionet publike dhe arsimin. SKZH parasheh aktivitete konkrete krahas Strategjisë për TI-në si:

1. Themelimi i një Këshillit Kombëtar për TI-në, për të koordinuar aspektet e ndryshme për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë për TI-në.
2. Mbështetje për bizneset kosovare të TI-së (përmes Fondit për Punësim dhe Zhvillim) për të eksportuar shërbime jashtë vendit dhe tek bizneset e tjera për të përmirësuar operacionet e bizneseve të tyre përmes përdorimit të TI-së.
3. Miratimi i standardeve relevante ndërkombëtare të TIK-ut për institucionet publike dhe bizneset.
4. Zbatimi i Programit për Ekonominë Digjitale të Kosovës - KODE e cila do të përfshinte vendosjen e infrastrukturës për broadband (brezëgjërë) dhe shpejtësi të lartë dhe zhvillimin e burimeve njerëzore për ekonomi digjitale. Këto masa do të ndihmojnë në uljen e kostove operacionale dhe në krijimin e efikasitetit, rrjedhimisht, duke u lejuar kompanive shtetërore dhe private burime direkte për investime në fushat e tjera. Shtimi i investimeve dhe inovacionit do të krijojë shkallë më të lartë të rritjes ekonomike.

Programi i Reformës Ekonomike (PRE) 2018-2020/2019-2021 përmban korniza makroekonomike dhe fiskale afatmesme, si dhe një agjendë të reformës strukturore e cila i përshkruan reformat sektoriale kyçe që synojnë

¹²<https://stikk.org/en/kosict-8th-edition-24-25-oct-2019/>

¹³http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

përmirësimin e konkurrencës, rritjes dhe krijimit të vendeve të punës¹⁴. Dokumenti i parasheh një sërë masash dhe aktivitete për sektorin e TIK për tri vite, si: krijimi dhe operimi i qendrave rajonale inovative në Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan me laboratorë dhe pajisje të tjera të nevojshme; grantet për projekte inovative shkencore dhe aktivitete për NVM, të biznese të sapofilluara dhe OJQ dhe disa aktivitete që e mbështesin hulumtimin dhe zhvillimin, inovacionin dhe ekonominë digjitale.

Strategjia e Agjendës Digjitale 2020 ekziston paralelisht me Strategjinë për TIK-un.

Objektivi i parë është që të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm në kuptimin gjeografik të rrjeteve broadband të komunikimit elektronik në tërë territorin kombëtar dhe promovimin e përdorimit të shërbimeve të komunikimit elektronik. Objektivi i dytë është që të arrihet siguria dhe integriteti i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik, në mënyrë që të rritet besimi i publikut dhe bizneseve në hapësirën kibernetike. Objektivi i tretë është që të promovojë zhvillimin e e-bizneseve. Ky është një objektivi për të nxitur banorët e Kosovës që të mësojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për përdorimin e suksesshëm të TIK-ut dhe për t'u përfshirë në Shoqërinë Informativë për të përmirësuar cilësinë e tyre të jetës dhe për të zvogëluar përjashtimin e tyre social.

3.3 Rishikimi i pritur i Strategjisë Kombëtare për TI-në

Gjatë dy viteve të fundit, ka pasur diskutime për një rishikim të Strategjisë së Kosovës për IT-në. Është sugjeruar nga disa zyrtarë qeveritar që ky rishikim duhet të bëhet nga STIKK.

MZHE ka deklaruar se ata janë në proces të sigurimit të mbështetjes ndërkombëtare në mbështetje të këtij rishikimi. Në anën tjetër, përfaqësuesit e GIZ-it e kanë konfirmuar se mund t'i ofrojnë MZHE-së mbështetje për rishikimin e strategjisë për IT-në, nëse kjo kërkohet nga MZHE. Sipas MZHE, pritet që ky rishikim do të nis në fillim të vitit 2020.

Për disa hisedarë, është hutuese se ekziston një

Agjendë Digjitale dhe Strategji për TI-në. Sidoqoftë, MZHE shpjegon se këto dokumente shërbejnë për qëllime të ndryshme. Sidoqoftë, mund të jetë e nevojshme që të reflektohet nëse kjo është ideale në të ardhmen.

3.4 Diskutimet e Kapitullit

Për shkak se koordinimi dhe monitorimi i strategjisë për TI-në nuk janë zbatuar dhe përkrahur me burime financiare sipas planifikimit, zbatimi i nëntë shtyllave të ndryshme ishte i pabarabartë dhe kryesisht i pakoordinuar. Kur përpjekjet e koordinimit u shuan, mbeti në dorën e hisedarëve individual që të zbatonin detyrat që më për së afërmi përputheshin me interesat, burimet dhe aftësitë e tyre.

Sidoqoftë, u zbatuan disa projekte që kërkonin bashkëpunim intensiv dhe bashkëpunim në mes të sektorit publik, sektorit privat dhe donatorëve ndërkombëtar. Këtu përfshihen themelimi i MTIK, reforma tatimore dhe themelimi i Tech-Park Prishtina. Ato ishin të suksesshme falë rolit koordinues të MZHE dhe mbështetjes nga lobimi dhe kontributi i STIKK.

Strategjia për TI-në ka qenë instrumentale dhe shërbeu si bazë për disa strategji të tjera kombëtare. Në kohën e punimit të këtij raporti, ajo ende citohej nga Qeveria e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtar.

Gjatë intervistave me STIKK, ata e cekën se e kanë paraparë që të ndërmarrin rishikimin e strategjisë në vitin 2020. Sidoqoftë, ne sugjerojmë që STIKK është më mirë që të jetë një hisedarë dhe kontribuues kyç por, jo rishikues apo koordinator i strategjisë nacionale të TIK. Krahas kësaj, një analizë gjithëpërfshirëse e situatës duhet të bëhet përpara hartimit të një strategjie të re. Njësoj sikurse është bërë për strategjinë ekzistuese.

Për më tepër, është pohuar se MZHE është duke kërkuar mbështetje nga donatorët për të financuar rishikimin e kësaj strategjie. Në besojmë se do të ishte më së miri që Qeveria e Kosovës dhe më saktësisht për MZHE-në që të financojnë dhe koordinojnë këtë strategji.

¹⁴Procesi i hartimit të Programit të Reformës Ekonomike (PRE) udhëhiqet nga Ministri i Financave si Koordinator Kombëtar dhe koordinohet nga Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) në Zyrën e Kryeministrit, përderisa koordinorët e fushës së politikave nga ministrinë e linjës. PRE i paraqet bazat ekonomike të vendeve kandidate dhe vendeve kandidate potenciale për plotësimin e kriterëve për pranimin ekonomik dhe bazën për dialogun e tyre ekonomik me Bashkimin Evropian.

4 Peizazhi i TIK-ut në Kosovë

Peizazhi i TIK-ut në Kosovë është i larmishëm dhe mbulon një gamë gjithëpërfshirëse të organizatave publike, private, vendore dhe ndërkombëtare. Në këtë kapitull do të diskutohet peizazhi nga këndvështrimet në vijim:

- Organizatat rregulluese dhe përcaktuese të politikave të cilat janë duke e nxitur apo formësuar përmirësimin e TIK-ut në Kosovë.
- Organizata të cilat promovojnë, mbështesin dhe zhvillojnë drejtpërdrejt TIK-un,
 - Institucionet e arsimit të lartë që ofrojnë arsimim, hulumtime dhe mbështetje tjetër,
 - Organizatat të cilat në mënyrë indirekte mbështesin dhe promovojnë TIK-un, dhe
 - Kompanitë vendore dhe ndërkombëtare që


marrin pjesë në treg.

4.1.1 Organizatat rregulluese dhe përcaktuese të politikave që e çojnë përpara përmirësimin e sektorit të TIK-ut

TIK-u paraqitet në mandatet e disa departamenteve, organeve rregulluese dhe agjencive qeveritare. Hulumtimi ynë gjeti se disa departamente qeveritare luajnë një rol kritik në zhvillimin e sektorit vendor të TIK-ut. Departamentet qeveritare që janë paraqitur në Figurën 1 në mënyrë eksplicite janë pjesë e strategjisë për TI-në dhe zbatimit të saj si prijës të programeve të caktuara, politikave apo si rregullues kyç.

Figura 1: Një përshkrim i qeverisjes së kaluar të sektorit të TIK-ut

Përshkrimi i gjendjes aktuale në rrjetet dhe shërbimet që lidhen me TIK Qeverisja Sektoriale - Pjesëmarrësit kryesorë



Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Departamenti i Teknologjisë Informative dhe Komunikimit është përgjegjëse për të propozuar, përpiluar dhe monitoruar zbatimin e politikave/dokumenteve strategjike dhe legjislacionit në sektorin e postës, komunikimit elektronik dhe shoqërisë së informacionit. Krahas kësaj, në sektorin e shoqërisë së informacionit, ajo

mbështet teknologjinë informative dhe inovacionin, si tregtia elektronike; mbështet qasjen në teknologji dhe nxit zhvillimin e teknologjisë informative sistemet e zhvillimit njerëzor

Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse që të propozojë, hartojë dhe koordinojë të gjitha politikat dhe strategjitë që kanë të bëjnë

me TIK-un në sektorin publik të Republikës së Kosovës, pra për përdorim të TI-së brenda institucioneve. Në kuadër të kësaj ministrie janë dy agjenci, **Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI)** dhe **Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)**.

- **Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI)** është një agjenci e Ministrisë së Administratës Publike. Ajo i propozon dhe i koordinon të gjitha politikat që kanë të bëjnë me teknologjinë informative dhe komunikuese në institucionet e Republikës së Kosovës; harton dhe sigurohet për zbatimin e strategjisë për qeverisje elektronike dhe planin përkatës të punës, për aprovim në Qeveri; e menaxhon dhe mbikëqyr zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë me teknologjinë informative në institucionet e Republikës së Kosovës. ASHI, po ashtu e mbështet zhvillimin e teknologjisë informative, e promovon investimin në fushën e shoqërisë së informacionit, zhvillimin e sistemeve trajnuese për teknologjinë informative dhe zhvillimin e koordinimit, menaxhimit dhe mbikëqyrjes së proceseve dhe mekanizmave të qeverisjes elektronike në fushat në vijim: Infrastruktura e TIK-ut për institucionet publike, zgjerimi i shërbimeve të internetit përmbytja e internetit në institucionet publike, sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale në formë elektronike në pajtim me legjislacionin në fuqi; e lehtësojnë qasjen në informacionin publik në formë elektronike, në bashkëpunim me IKAP-in; e bëjnë identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për trajnime elektronike të Shoqërisë së Informacionit për punonjësit e institucioneve të Republikës së Kosovës.

- **Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)** është një agjenci e Ministrisë së Administratës Publike që fokusohet në ndërtimin e kapaciteteve të shërbyesve civil. IKAP bashkëpunon ngushtë me ASHI-në për të identifikuar nevojat e shërbyesve civil për aftësi të TI-së dhe për të ofruar programet trajnuese në lidhje me TI-në për shërbyesit civil në Kosovë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), është përgjegjëse për zhvillimin e kërkimeve shkencore dhe sistemin e arsimit të lartë dhe promovimin e zhvillimit teknologjik. Ajo është përgjegjëse për miratimin e politikave publike në fushën e kërkimeve dhe sistemeve arsimore. Për më tepër, MASHT është përgjegjëse për të financuar programet e veta zhvillimore dhe të politikave. Rregullimi aktual për

organizimin e brendshëm të MASHT-it, i jep mandat Departamentit për Arsimin e Lartë, Shkencë dhe Teknologji (DALSH) si organi kryesor në fushën e Arsimit të Lartë, Kërkimeve dhe Teknologjisë.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP). Funksionet dhe përgjegjësitë e ARKEP janë të rregulluara me Ligjin Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike i cili është miratuar nga Kuvendi në vitin 2012. Sipas këtij ligji, ARKEP është autoriteti kombëtar rregullativ në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, i cili i kryen detyrat e përcaktuara nga ky Ligj dhe nga legjislacioni tjetër në fuqi dhe i zbaton politikat dhe strategjitë kombëtare të sektorit të komunikimit elektronik, të përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Më tej, ky ligj parasheh që ARKEP është një subjekt publik, i pavarur, jo buxhetor, ligjor me autoritet publik, i cili e ushtron aktivitetin e tij në pajtim me legjislacionin në fuqi. ARKEP është i pavarur në punën e tij dhe vendimmarrjen në kuadër të kompetencave të veta.

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) është agjencia shtetërore kosovare me mandat që të promovojë dhe përkrahë investimet, eksportet, turizmin, NVM-të, dhe Zonat e veçanta Ekonomike në Republikën e Kosovës. Një nga sektorët më të rëndësishëm që e promovon kjo agjenci është Teknologjia Informative dhe Komunikimi.

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrjes (MIN).

Për të fuqizuar politikat inovative dhe zhvillimin, në vitin 2017 Qeveria e Kosovës (QeK) e ka themeluar një Ministri të re për Inovacion dhe Ndërmarrje. MIN është përgjegjëse për hartimin, zbatimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e inovacionit dhe ndërmarrjes. MIN është e fokusuar në promovimin e inovacionit dhe krijimin e mekanizmave koordinues institucional në mes të shkencës, sektorit privat dhe politikë bërjes. Departamenti i Inovacionit në kuadër të MIN e ka një rol domethënës në politikë bërje dhe në zbatimin e politikave në fushën e inovacionit.

Ministria e Shëndetësisë/Departamenti i Sistemit të Informacioneve Shëndetësore (SISH) është përgjegjëse që të propozojë, hartojë, sigurojë dhe monitorojë zbatimin e politikave/strategjive dhe legjislacionit në lidhje me zhvillimin e SISH.

4.1.2 Organizatat që e promovojnë dhe zhvillojnë drejtpërdrejt sektorin e TIK-ut në Kosovë

STIKK është themeluar në vitin 2008. Ajo është një Shoqatë me Anëtarësim të Bizneseve e cila aktualisht i ka mbi 200 anëtarë. Ata pretendojnë se e përfaqësojnë 90% të tërë tregut të TIK-ut në Kosovë. Në mesin e anëtarëve të tyre përfshihen edhe pesë universitete të cilat kanë programe të TI-së dhe tri shoqata të specializuara në fusha të caktuara të TI-së. Në përpjekjet drejt zhvillimit të industrisë së TIK-ut, STIKK ka zbatuar projekte të panumërta me synim që të promovojnë sektorin e TIK-ut në Kosovë, që të përmirësojnë kornizën e tij rregullative, kërkime dhe analiza specifike për industrinë, dhe që të lehtësojnë zhvillimin profesional të pjesëve përbërëse të sektorit. STIKK përfaqëson një hisedarë madhor në vend i cili njihet nga TIK-u ndërkombëtar dhe vendor

STIKK është anëtare e Rrjetit të Grupimit të 3B-ve të TIK-ut (3B ICT Cluster Network)¹⁵.

Qendra Inovative e Kosovës (ICK) është Organizatë Jo Qeveritare synimi i së cilës është që të lidh komponentin e hulumtimeve dhe zhvillimeve të fushës shkencore me sektorin e biznesit, duke u fokusuar në krijimin e vendeve të reja të punës me orientim drejt të ardhmes, në bazë të diturisë dhe teknologjisë së re. Ajo e mbështet ndërmarrësinë, inovacionin dhe zhvillimin e bizneseve me bazë komerciale, me fokus në teknologjinë informative dhe komunikuese. Qendra i mbështet kompanitë e sapokrijuara dhe ato ekzistuese me potencial për rritje. Misioni i saj është që të krijojë vende të reja të punës dhe prosperitet të bizneseve në sektorin e TIK-ut në Kosovë dhe Energjisë së Gjelbër përmes inovacionit, mbështetjes së ndërmarrësve, kompanive të sapokrijuara dhe bizneseve ekzistuese¹⁶.

Open Data Kosovo është një Organizatë Jo-Qeveritare, që e promovon idenë se të dhënat publike duhet të jenë të hapura në dispozicion për

t'u përdorur nga të gjithë dhe për t'u riprodhuar sipas dëshirës, pa kufizime nga të drejtat e autorit, patentat apo mekanizmat e tjerë. Open Data Kosovo beson në përdorimin e teknologjisë qytetare dhe humanitarizmin digjital për qeveri të hapur. Open Data Kosovo kontribuon në zhvillimin e një skene vendore dhe drithëruese të teknologjisë. Duke punuar si laborator që ofron mentorim dhe programe trajnuese, angazhon zhvilluesit vendor të softuerëve dhe ndihmojmë në ndërtimin e një komuniteti përreth përdorimit të teknologjive që po lindin dhe që ofrojnë mundësi për të zhvilluar aplikacioni për të mirën shoqërore me të dhënat e hapura të Kosovës.

Gjirafa Lab është një fabrikë e sapo nisur, e punuar për ndërmarrësit në internet të cilëve iu mungon qasja në burime dhe në treg. Si një fabrikë e sapo nisur, ky Laborator do të ofrojë hapësira, mentorim, krijimin e rrjeteve, teknologji, vënie në pah të talentit dhe financim për ndërmarrësit kompetent në internet, duke krijuar zgjidhje për tregun e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore (IRJ e Maqedonisë). Për dallim nga të tjerët, Gjirafa Lab përbëhet nga njerëz të cilët e kanë bërë këtë më parë.

Gjirafa Lab është ndërtuar nga Gjirafa, Inc., me ndihmë nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), me qëllim të ndërtimit të Ekonomisë së Internetit në Kosovë dhe rajon. Ndërmarrësit do të kenë mundësinë që të transformojnë idetë/prodhimet e tyre teknologjike në biznese të suksesshme online dhe të zgjidhin probleme reale të shoqërisë.

Gjirafa Lab, një inkubator i porsa nisur rajonal, ofron hapësira për bizneset e sapo nisura dhe mbështetjen përkatëse.

Ndërmarrësit do të kenë mundësinë që të transformojnë idetë/prodhimet e tyre teknologjike në biznese të suksesshme online dhe të zgjidhin probleme reale të shoqërisë. Gjirafa ofron mbështetje financiare për bizneset e sapo nisura në sektorin e TIK-ut, në formën e investitorëve Engjëj, në këmbim të kuotave të aksioneve.

Gjirafa është e fokusuar kryesisht në sektorët e TIK-ut dhe i lidh bizneset e sapo nisura me qendrën e inkubatorit dhe kërkon fonde (mbjellëse) me mbështetje shtesë. Ajo e ka ndërtuar një platformë online për procesin e aplikimit dhe shqyrtimit të ideve inovative përmes thirrjeve të hapura.

¹⁵https://3b-ict.net/about-us/ict-members/cluster_associations/

¹⁶<https://ickosovo.com/about>

4.1.3 Institucionet e Arsimit të Lartë

Sipas Agjencisë së Kosovës për Akreditim, aktualisht ekzistojnë 13 institucione të arsimit të lartë, publike dhe private, të akredituara për të ofruar programe studimore të ndërlidhura me TIK-un në kurrikulën e tyre. Në kurrikula mbizotërojnë disiplinat teknike, përkundër se shkathtësitë e buta dhe njohuritë si menaxhimi i biznesit, puna në grup, menaxhimi i procesit, menaxhimi i konfliktit, aftësitë për të punuar në një larmi të kushteve dhe mjediseve, aftësitë prezantuese etj, janë tejet të kërkuara nga industria. Qasjet ndër-disiplinore po ashtu nuk janë të mbuluara si duhet në programin akademik.

4.1.3.1 Universitetet Publike

Janë tri universitete publike në Kosovë, të cilat ofrojnë studime përkatëse baçelor dhe master në TIK

- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti".

4.1.3.2 Universitetet/Kolegjet Private

Gjithashtu janë disa universitete dhe kolegje private në Kosovë të cilat ofrojnë programe të ndërlidhura me TIK-un:

- Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) ofron programe të Teknologjisë Informative në nivelin baçelor dhe atë master. Kolegji UBT e ka bazën në Prishtinë dhe operon në katër kampuse: UBT Prishtina, UBT Kampusi i Inovacionit, UBT Prizren dhe UBT Ferizaj.
- Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK) e ka një program të Teknologjisë Informative në studimet baçelor,
- Kolegji Riinvest e ka një program për TIK-un në nivelet baçelor dhe master.
- Kolegji AAB e ka një program të Inxhinierisë Softuerike në nivelet baçelor dhe master,
- Kolegji Iliria i ka dy programe baçelor për TIK-un: Menaxhim dhe TI, dhe Shkenca Kompjuterike - TI e Aplikuar. Në nivelin master ata ofrojnë një Program të Menaxhimit dhe TI-së.
- CACTTUS Education ka një sërë programesh për inxhinieri të sistemeve dhe softuerëve ku ofron arsimim profesional dy vjeçar në TIK.

4.1.3.3 Aktivitetet e tjera arsimore

Ekzistojnë disa qendra dhe akademi trajnuese profesionale të cilat ofrojnë programe të akredituara nga Cisco, Microsoft, ECDL, Oracle, RedHat etj.

Akademia jCoders është një institucion jashtë shkollor arsimor me 6 qendra në Kosovë dhe Shqipëri. jCoders është dizajnuar si një kanal alternativ për ofrimin e përvojave të mësimi praktik në teknologji për fëmijët dhe të rinjtë duke filluar nga moshë 8 vjeçare. Misioni i jCoders është që të ofrojë përvojë mësimore e cila i zhvillon aftësitë për shekullin e 21-të dhe e përgatit gjeneratën e ardhshme për kërkesat kreative të realitetit të ri në vendet e punës.

4.1.4 Organizatat që e promovojnë dhe zhvillojnë indirekt sektorin e TIK-ut në Kosovë

Odat Ekonomike e Kosovës - OEK - e analizon situatën ekonomike në Kosovë dhe në mënyrë aktive propozon forma të reja dhe të avancuara të bizneseve lokale dhe stimulon internacionalizimin e ndërmarrësisë së Kosovës. OEK kontribuon në zhvillimin e ndërmarrjeve dhe me profesionalizmin dhe vendosmërinë e saj i ndihmon bizneset e Kosovës që t'i përthithin vlerat evropiane. Detyrat kryesore të OEK:

- Të bashkëpunojë me institucionet qeveritare për të formuluar një strategji të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik,
- Të zhvillojë dhe kryejë shërbimet e një sistemi integral të biznesit dhe informacionit në lidhje me bazën e të dhënave kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Promovimi i tregtisë së jashtme duke organizuar kontakte të biznesit në mes të partnerëve vendor dhe të huaj,
- Pjesëmarrja në procesin e përhershëm të inovacionit dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve

Oda Ekonomike e Kosovës dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, janë duke implementuar një projekt që për qëllim ka transformimin digjital dhe konkurrueshmërinë e sektorit privat. Fillimisht është bërë një studimi mbi digjitalizimin i cili u fokusua në 3 sektor kyç përkatësisht në sektorin e prodhimit, agrobiznesit dhe shërbimeve. Faza tjetër do të vazhdohet me transformimin digjital

që do i'u ndihmonte bizneseve Kosovare në ngritje të kapaciteteve, rritje të prezencës gjeografike e digjitale, depërtim në tregje të reja dhe orientim kah konsumatori.

BONEVET është një institucion arsimor jo fitimprurës dhe jo formal i themeluar në vitin 2014 nga fondacioni privat UNË E DU KOSOVËN me seli në Prishtinë.

BONEVET është një mjedis miqësor për fëmijët, të rinjtë dhe rejat i dizajnuar që të stimulojë kurozitetin, imagjinatën dhe kreativitetin e fëmijëve. Fëmijët nxiten që në mënyrë aktive të luajnë, t'i krijojnë vet lojërat e tyre, të punojnë së bashku me fëmijët e tjerë, të programojnë robotë, të krijojnë prototipa me printerët 3D dhe makinat CNC, të zgjidhin gjëgjëza dhe enigma, të dizajnojnë dhe ndërtojnë teatro të kukullave, të kuptojnë rëndësinë e vlerave, të zhvillojnë aftësitë e tyre komunikuese, të lexojnë libra dhe të mësojnë gjuhë.

4.1.5 Peizazhi i ndërmarrjeve në sektorin e TIK-ut në Kosovë

Shumë prej organizatave të përshkruara në pjesën paraprake të këtij kapitulli janë të financuara publikisht. Në këtë pjesë do të përshkruhet peizazhi i sektorit privat në Kosovë.

Sektori privat në TIK karakterizohet nga shumë kompani të vogla me më pak se 5 punëtorë dhe bashkëpunëtorë të pavarur. Janë disa kompani të mesme dhe kompani më të mëdha, ku CACCTUS llogaritet si një prej më të mëdhave. Ndërmarrjet e mesme dhe më të mëdha kanë më shumë gjasa që të jenë të interesuara në eksportin e shërbimeve dhe shërbimet vendore për sektorin publik/të korporatave. Madhësia e dhe përbërja e saktë e sektorit të TIK-ut nuk është e qartë dhe statistikave në fakt janë kundërthënëse (Shih Kapitullin 6.7).

Sektori i TIK-ut për nga natyra e tij dhe përkufizimi i tij i gjerë është i larmishëm dhe shtrihet nga furnitorët e harduerit dhe shërbimeve bazike të TI-së deri tek infrastruktura e komunikimeve, zhvillimi i softuerit, e-tregtia, shitja me pakicë dhe Kontraktimi i Procesit të Biznesit.

Janë vetëm disa kompani vendore të TIK-ut të cilat paraqiten në shumë raporte, strategji dhe struktura këshilluese dhe si kampion të sektorit.

4.2 Diskutimi i Kapitullit

Peizazhi i TIK-ut në Kosovë është zgjeruar në të gjitha nivelet e diskutuara në këtë kapitull. Sektori i TIK-ut është duke u rritur, dhe përdorimi i TIK-ut në sektorin publik dhe privat është po ashtu duke u rritur.

Disa agjenci të specializuara në sektorin publik janë ngritur në përgjigje të digjitalizimit të shërbimeve publike dhe infrastrukturave teknologjike, si ofrimi i broadband-it, spektrit dhe funksioneve të tjera rregulluese. Kjo mbase është instrumentale në shtyrjen e kërkesës për aftësi profesionale të TIK-ut në vend.

Disa përpjekje për tu zhvilluar ndërmarrje si Gjirafa, janë duke kontribuar në larminë e peizazhit. Ka shumë përpjekje për të injektuar aftësitë e TIK-ut në shkolla, sektorin publik si dhe atë privat.

Disa kompani vendore kanë përparuar ndërkombëtarisht dhe mbështeten në mënyrë aktive nga STIKK në përpjekjet e tyre për t'u qasur në tregjet rajonale. Sidoqoftë, shumica e kompanive të TI-së janë ende mjaft të vogla.

5. Dëshmia e matjes së vazhdueshme të TIK-ut në Kosovë

Ky kapitull ka të bëjë me përpjekjet e akterëve me rëndësi në Kosovë për të vlerësuar, matur dhe përcjellë performancën e sektorit të TIK-ut. Nga informacionet e marra kuptohet se vlerësimi i sektorit të TIK i bërë në vitin 2013, i cili çoi tek strategjia kombëtare e TI-së, ishte i fundit i cili e shikoi sektorin në aspekt gjithëpërfshirës, përdërisa vlerësimet e mëtejme i janë referuar atij gjatë shumë viteve në të ardhmen, përkundër shumë ndryshimeve që kanë ndodhur në ekosistem që atëherë. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të strategjisë së Kosovës për TI-në, i cili do të mundësonte një shikim të përditësuar të shëndetit të sektorit, nuk ka ndodhur kurrë deri në shkallën në të cilën ishte paraparë.

Kapitulli do të fillojë duke e shqyrtuar dizajnin origjinal të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të propozuar nga Strategjia e Kosovës për TI-në. Më pas, do të diskutohen instrumentet e ndryshme të cilat i përcjellin statistikave kyçe të TIK-ut. Gjithashtu do të shqyrtohen disa programe të dizajnuara nga donatorët ndërkombëtar, të cilat i kanë përfshirë vlerësimet e

përditësuar të peizazhit të TIK-ut dhe rrjedhimisht ofrojnë një analizë më të re të performancës së TIK-ut.


5.1 Monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë për TIK-un

Strategjia kombëtare për TIK-un e përfshinë një plan të qartë të monitorimit dhe vlerësimit për të matur përparimin e zbatimit të strategjisë. Në mesin e aspekteve të tjera, aspektet në vijim përmenden në mënyrë specifike:

- Duke treguar nëse procesi i zbatimit të strategjisë IT është ende në rrugën e duhur.
- Zbulimi i informacionit mbi efektivitetin e strategjisë për TIK-un dhe masave të saj.
- Ofrimi i komenteve të cilat mund të shërbejnë si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të strategjisë.

Sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë së Kosovës për TI-në është i ndarë në katër nivele, duke e ndjekur kornizën logjike (Log-Frame) (Shih Figurën 2).

Figura 2: Katër nivelet e sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë së Kosovës për TI-në



Qëllimet e përgjithshme janë rrjedhimisht të ndërlidhura në mënyrë logjike me qëllimet e niveleve më të ulëta. Treguesit kuantitativ i janë caktuar secilit qëllim veç e veç të nivelit të 1-rë (qëllimi i përgjithshëm) dhe të 2-të (shtyllat strategjike), të cilët do të duhej ta lehtësonin

matjen e përparimit të zbatimit. Treguesit në nivelet 3 dhe 4 e matin përparimin e secilës prej detyrave në kuadër të 9 shtyllave strategjike dhe do të duhej të ishin më të lehtë për t'u matur se sa nivelet 1 dhe 2.

5.2 TIK-u në statistikat zyrtare

Të dhënat që janë në dispozicion për sektorin e TIK-ut në Kosovë prodhohen kryesisht nga STIKK dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Sidoqoftë, këto të dhëna nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm mbi ndikimin e përgjithshëm të industrisë së TIK-ut në rritjen ekonomike dhe në punësim, shpenzimet në sektorin e TIK-ut dhe financimin publik. Deri tani, burimet në vijim janë në dispozicion në Kosovë:

5.2.1 Barometri i Industrisë së TI-së i SEE 2014

Projekti "Barometri i Industrisë së TI-së i Evropës Juglindore" (SEE ITIB) e ka zhvilluar një metodologji për të realizuar Barometrin e Parë të Industrisë së TI-së në Evropën Juglindore (SEE ITIB). Projekti synoi që të mbledh informacione bazike për kompanitë e TIK-ut në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe për të ofruar një pamje më të thellë në vlerën e tregut kombëtar të TIK-ut si dhe në të qenit e tyre konkurrues. Projekti i ka përfshirë pesë shtete: Malin e Zi, Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë dhe Serbinë. Barometri i parë i Industrisë së TI-së në Evropën Juglindore u zhvillua në vitin 2014.

5.2.2 Barometri i TI-së në Kosovë (BITIK)

Barometri i TI-së synon që të mbledh informacione bazike vetëm për kompanitë e TIK-ut. Ai fokusohet në eksplorimin e çështjeve në vijim në lidhje me sektorin e TI-së në Kosovë:

- Pasqyra e gjendjes së përgjithshme të zhvillimit të TI-së në Kosovë;
- Analiza krahasuese;
- Trendët e fundit të eksportit në mes të shteteve të synuara (potenciali për eksport, aktivitetet e eksportit, bashkëpunimi ndërkombëtar, pengesat e eksportit);
- Analiza e Burimeve Njerëzore;
- Analiza cilësore e trendëve të fundit në industrinë e TI-së.

Për sa i përket metodologjisë së përdorur, Barometri i TI-së 2019 u zhvillua duke përdorur teknikën e të intervistuarit personal me ndihmë të kompjuterit (CAWI). Madhësia e mostrës përbëhej nga 38 intervista me kompani të TI-së, shumica e tyre të vendosura në Prishtinë. Për shkak të mostrës së vogël, Barometri i TI-së konsiderohet se nuk i përfaqëson mjaftueshëm kompanitë e TIK-ut.

Gjetjet kryesore të barometrit të TI-së 2019 janë si në vijim:

- 61% e kompanive të TI që morën pjesë në këtë hulumtim punojnë në tregun ndërkombëtar, krahasuar me tregun vendor që janë 39% e tregut të tyre.
- Kompanitë vendore biznesin me kompani ndërkombëtare e bëjnë në disa mënyra si: eksport i drejtpërdrejtë nga Kosova për klientin jashtë vendit; degë/nëndegë në tregun e synuar, si Partner Distribues/Partner Lokal (agjent shitjesh) me një zyrë përfaqësuese, si dhe me një ndërmarrje të përbashkët.
- Tregjet horizontale më të njohura janë: Menaxhimi i dokumenteve; Business Intelligence/ Ruajtja i të Dhënave; Optimizimi i procesit të biznesit; E-commerce dhe Mirëmbajtja e Mbështetja dhe Përshtatja e produkteve.
- Evropa Qendrore, SH.B.A. dhe Mbretëria e Bashkuar kanë potencialin më të lartë për eksport. Vendet me potencialin më të lartë eksportues që u përmendën në Evropë ishin Zvicra, Gjermania, pastaj Amerika e Veriut (SHBA dhe Kanada) dhe Mbretëria e Bashkuar. Azia Lindore, Lindja e Mesme dhe Afrika shihen pa potencial për eksport.
- Ka një rritje në numrit mesatar të të punësuarve nga 14% në 2018 në 16% në 2019.
- Trendi pozitiv në rritjen e numrit mesatar të të punësuarve dhe pagave e tyre pritet të vazhdojë të rritet në vitin 2019.
- Në aspektin e funksionimit të kompanive TI në Kosovë, ato ofrojnë kryesisht: softuer/ TI, pastaj shërbime për produkte harduerike dhe produkte softuerësh. Ato përdorin kryesisht Windows dhe teknologjinë NET për të ofruar shërbime. JAVASCRIPT, HTML, XML dhe PHP janë gjuhët më të përdorura të programimit. Teknologjitë më të njohura të databazave midis kompanive IT janë MS SQL/MYSQL, pastaj MS SQL Server.
- Sektori më i popullarizuar për nevoja lokale është në shërbimet financiare ndjekur nga Sektori Publik, Shërbimet dhe Telekomunikacioni (Wireless dhe Mobile), ndërsa sektori më i njohur për tregun ndërkombëtar është Shërbimet IT dhe Kontrata të jashtme dhe Shërbimet komunale.
- Lista e çertifikatave është e gjatë dhe e larmishme. Më shumë se gjysma e mostrës, përkatësisht 58% prej tyre deklaruan se çertifikimi profesional i menaxhimit të projektit (PMP) vlen për punonjësit e tyre të ndjekur nga çertifikatat e Microsoft-it 53%, dhe Scrum 50%. Tri nga katër kompanitë e intervistuar të Teknologjisë Infor-

mative (TI) në Kosovë (74%) i eksportojnë shërbimet dhe prodhimet e tyre.

Barometri i TI-së supozohej të ishte vegla më e rëndësishme për Sistemin e Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjisë së Kosovës për TI dhe sigurimin e informatave të sakta statistikore mbi industrinë e TI-së. Por BITIK kryesisht ka dështuar në krijimin e një pasqyre të qartë të shëndetit të sektorit për shkak të fokusit të tij të kufizuar.

5.2.3 Anketa për përdorimin e TIK-ut në Kosovë

Në vitin 2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) i ka publikuar për herë të parë rezultatet e Anketës për Teknologjinë Informativë dhe të Komunikimit për vitin 2017. Në vitin 2019 ASK e botoi publikimin e dytë me rezultatet e Anketës për TIK-un në Kosovë për vitin 2018. Fokusi i kësaj ankete është goxha i ngushtë për shkak se mbledh informacion për përdorimin e TIK-ut në tërë territorin e Republikës së Kosovës nga amvisëritë dhe individët e grup moshës 16-74 vjeçar.

Rezultatet kryesore janë si në vijim.

- 93,2% e të anketuarve kanë deklaruar se ata kanë qasje në internet në shtëpi.
- 75,1% që i përdorin telefonat mobil apo telefonat e mençur për t'u qasur në internet gjatë tre muajve të fundit në vitin 2018.
- Pothuajse çdo i pesti individ e ka përdorur internetin për qëllime private për aktivitete si shërbimet publike, agjencitë qeveritare apo administratë gjatë 12 muajve të fundit
- Shumica (63,6) deklaruan se kurrë nuk kanë blerë apo porositur mallra dhe shërbime për përdorim privat në internet herën e fundit në vitin 2018.

5.2.4 Të dhënat e Eurostat

Në vitin 2019 Eurostat e publikoi një fletushkë "Shifrat bazike në vendet e zgjerimit". Kjo fletushkë i paraqet të dhënat e fundit të Eurostat për një numër të vogël të treguesve kryesor në fushat ekonomike dhe shoqërore për vendet e zgjerimit. Informacioni vetëm relevant për studimin është përqindja e amvisërive të cilat kanë qasje në internet në shtëpi. Sipas këtyre shifrave në krahasim me vendet e tjera për zgjerim, Kosova e ka përqindjen më të lartë të amvisërive që kanë qasje në internet 89% në vitin 2017 dhe 93% në vitin 2018. Kjo e rreshton Kosovën mbi

mesataren e shteteve të BE-së (89%)¹⁷.

5.2.5 Statistikat e publikuara nga Open Data Kosova

Në tetor të vitit 2019 u lansua platforma duke u bazuar në të dhëna të marra nga MASHT, MTI, dhe ATK, platforma është e mbushur me mijëra të dhëna që paraqesin lidhje të ndryshme mes çështjeve me rëndësi të madhe për fushën e TIK. "The Future Workplace"¹⁸, një platformë digjitale e bazuar në të dhëna për të ofruar analiza mbi trendët e zhvilloimit të sektorit të TIK-ut në Kosovë, i cili është financuar nga Fondacioni Mileniumi i Kosovës (Millennium Foundation Kosovo-MFK) dhe zbatohet nga Open Data Kosovo dhe Oda Ekonomike e Kosovës. Ai synon që bërësit e politikave të bëjnë politika me të mira, bizneset të bëjnë planifikim më të mirë të biznesit, dhe që të rinjtë të bëjnë planifikim më të mirë të karrierës.

Kjo platformë i përfshinë të dhënat për numrin e të diplomuarve nga universitetet (nga viti 2011-2015) dhe nga shkollat e mesme (2015-2018). Numri i të diplomuarve nga universiteti në fushat e TIK-ut në Kosovë në vitin 2015 ishte 3.475 apo një rritje prej 49% që nga viti 2011. Numri i të diplomuarve nga universiteti në fushat e ndërlidhura me TIK-un në Kosovë në vitin 2018 ishte 7334 apo një rënie prej 31% që nga viti 2015. Nuk është tërësisht e qartë se si u llogaritën të diplomuarit dhe se çka përfshijnë saktësisht fushat e ndërlidhura me TIK-un. Në kapitullin 6.6, ne vlerësojmë se punësimi total në vitin 2015 ishte gjithsej 9600, që do të thotë se 3.475 punëtorë të rinj hynë në tregun e punës. Për më tepër, të dhënat e punësimit tregojnë se në vitin 2016, punësimi ra në 7300, për t'u ngritur në vitin 2017 dhe më pas.

Të dhënat për numrin e bizneseve të TIK-ut të regjistruara tregojnë se janë të regjistruara 7762 biznese të TIK-ut. Ato po ashtu tregojnë një rritje konstante të bizneseve të reja të TIK-ut të regjistruara gjatë 10 viteve të fundit (413 biznese të TIK-ut në vitin 2008 dhe 1187 në vitin 2018). Sidoqoftë, të dhënat që kjo platformë duket se i ngatërron kanë të bëjnë me numrin e bizneseve të TIK-ut të regjistruara në vit. Për shembull, sipas të dhënave në platformë verehet se 1086 biznese të TIK-ut janë regjistruar në vitin 2017,

¹⁷<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/4031688/9684116/KS-03%E2%80%9119%E2%80%91048-EN-N.pdf/a56e60da-b179-466a-8f7e-f928399be623>

¹⁸www.thefutureworkplace.org

që janë baras me 14% të totalit të 7762 bizneseve të TIK-ut.

Numri i bizneseve të TIK-ut të raportuara në këtë platformë është shumë më i lartë se sa ai që raportohet nga burimet e tjera. Ndonëse, kur analizohen të dhënat e shkarkuara nga kjo platformë, mund të shihet se baza e të dhënave i përfshinë bizneset të cilat nuk i përkasin drejtpërdrejt sektorit të TIK-ut si: energjia elektrike, instalimi i kondicionerëve, zhvillimi i projekteve të ndërtimit, etj. Kështu që numri total prej 7762 bizneseve nuk e përfaqëson numrin real të bizneseve të TIK-ut.

5.3 Mbështetja ndërkombëtare dhe projektet

Që nga viti 2008, Kosova ka pasur mbështetje në TIK nga shumë donator ndërkombëtar. Mbështetja shtrihet nga ofrimi i drejtpërdrejt i shërbimeve, ndërtimi i kapaciteteve, deri të këshillat për politika, furnizimi me harduer dhe softuer dhe të tjera.

Në bazë të të dhënave të nxjerra nga Platforma për Menaxhimin e Ndihmës së Jashtme (Aid Management Platform – AMP), e cila është një mjet (sistem online) për qeverinë dhe donatorët që të përcjellin dhe shkëmbejnë informacionet për aktivitetet e financuara me ndihma e donatorëve. Duke kërkuar projektet që ka të bëjë me TIK-un, sistemet informative, furnizimet dhe softuerët e TI-së, u identifikuan një sërë projektesh të mbështetura nga donatorë të ndryshëm si Bashkimi Evropian, Qeveria Norvegjeze, Qeveria Suedeze, Qeveria Japoneze, Agjencia Austriake për Zhvillim, etj.

Gjatë hulumtimit tonë, Departamenti për TIK tregoi se disa donatorë ishin kontribuues të dobishëm në mbështetjen e strategjisë për TI-në dhe zbatimin e saj gjatë tetë viteve të fundit.

Gjithashtu, u studiuan burime të ndryshme të informacionit për të gjetur informacione relevante për projektet e donatorëve të TIK-ut. Tabela 1 dhe Tabela 2 në Shtojcën 1 në vijim lista aktuale e projekteve të ndërlidhura me TIK-un të financuara nga organizatat e ndryshme.

5.4 Studimet e fizibilitetit dhe studimet e donatorëve për dizajnimin e projekteve

Donatorët e mëdhenj si BE, Banka Botërore, GIZ, USAID, etj. ofrojnë fonde domethënëse për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Kosovës. Aktivitetet e zbatuara me këto fonde e mbulojnë industrinë e TIK-ut së bashku me sektorët e tjerë shoqëror dhe ekonomik. Projektet e donatorëve përdorin vlerësime dhe burime të ndryshme për të përshkruar kontekstin e vendit, sfondin dhe analizën e problemit në sektorin e TIK-ut kur ata i përgatisin dhe i planifikojnë projektet/ndërhryjet e tyre.

Mbështetja e BE-së në sektorin e TIK-ut

BE-ja e mbështet sektorin e TIK-ut përmes "Programit të Veprimit për Kosovën për Vitin 2017 - Pjesa I - Mbështetja e BE-së për konkurrencën e sektorit të TIK-ut në Kosovë" (Programi i Veprimit). Programi i Veprimit është dokumenti kryesor për planifikimin e mbështetjes dhe ndërhyrjes së BE-së në fushën e Konkurrencës dhe Inovacionit në Kosovë, i cili është hartuar në vitin 2018. Krahas kësaj, dokumenti i veprimit e adreson boshllëkun e aftësive në sektorin e TIK-ut.

Veprimi, e njuh dhe e prezanton Strategjinë Kombëtare të Kosovës për TI-në si dokumentin kryesor në sektorin e TIK-ut, qëllimi i tij është që të elaborojë një strategji specifike për promovimin e zhvillimit të industrisë së TI-së në Kosovë në mënyrë që të promovojë transformimin digjital dhe të mbështesë Kosovën për t'u bërë një ekonomi e bazuar në njohuri. Veprimi, deklaroi se ndërhyrja e propozuar e veprimit është në linjë me strategjitë relevante në mes të tjerash edhe strategjisë së TI-së. Ai më tej deklaroi se "Veprimi është i bazuar në Strategjinë e Kosovës për TI, e cila është dokumenti kryesor për zhvillimin e sektorit të TI-së dhe se do të kontribuojë në arritjen e objektivave të vendosura"¹⁹. Sidoqoftë, Programi i Veprimit vetëm sa e përdori një referencë nga strategjia për TI-në. Referencat e vetme nga Strategjia për TI-në janë:

- "Ka potencial shumë të madh në biznesin e softuerëve, ekziston një nivel i ulët i specializimit dhe dallimit sa i përket teknologjive, industrive të synuara (specializimit vertikal) dhe zonave specifike funksionale (specializimit horizontal)".
- Aftësitë e TIK-ut që mungojnë janë: Program-

¹⁹Programi i Veprimit për Kosovën për Vitin 2017 - Pjesa I - Mbështetja e BE-së për Konkurrencën e Sektorit të TIK-ut në Kosovë

imi i ueb faqeve, JavaScript, Njohuritë për Integrimin e Sistemeve, SQL, Sistemet Realtime dhe .NET".

Veprimi i përdor të dhënat e Bankës Botërore si Treguesit e Zhvillimit Botëror për të paraqitur situatën në lidhje me eksportet e shërbimeve të TIK-ut në Kosovë për periudhën 200-2012. Ai po ashtu i përdor të dhënat e vitit 2015 të Administratës Tatimore mbi numrin e bizneseve të regjistruara të TIK-ut. Krahas kësaj, ky dokument i referohet Identifikimi i nevojave të tregut të punës në sektorin e TIK-ut të publikuar nga STIKK në vitin 2015.

KODE

Qeveria e Kosovës (QeK) ka pranuar një kredi nga IDA (Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim) në vlerë prej 20,700,000 € (25 milionë dollarë amerikanë) nga Banka Botërore për të zbatuar Projektin për Ekonomi Digjitale në Kosovë (KODE) nga viti 2019 deri në vitin 2023.

Projekti KODE është dizajnuar sipas tre komponentëve kryesore: Përfshirja Digjitale, Puna Dixhitale dhe fuqizimi, dhe Përkrahja për Zbatim të Projektit.

Me implementimin e këtij projekti pritet të përfillojnë:

- (a) banorët nëpërmjet qasjes në internet brezgjere të shpejtësisë së lartë dhe iniciativës për vetëdijësim digjital; (b) institucionet e kujdesit shëndetësor dhe shkollat fillore dhe të mesme.
- (c) operatorët e rrjetit mobil dhe klientët e tyre nëpërmjet shërbimeve mobile të cilësisë më të lartë;
- (d) të rinjtë e nën punësuar/të papunë nëpërmjet qasjes në programin e punës online;
- (e) studentët, hulumtuesit dhe stafi i Institucionet e Arsimit të Lartë nëpërmjet qasjes në rrjetin GÉANT në internet.

Huaja për projektin është në vlerë prej 20,700,000 euro (e barasvlershme me 25 milionë dollarë).

Parku Inovativ dhe Trajnues Kosovë-Gjermani (ITP)

Qeveria Gjermane, për të mbështetur fuqizimin e zhvillimit ekonomik të vendit, është pajtuar që të fokusohet në masat për promovimin e punësimit. Pas përfundimit të misionit të trupave Gjermane të KFOR-it në Prizren, Qeveria e Kosovës së bashku me Qeverinë Gjermane kanë vendosur që të zhvillojnë një studim të fizibilitetit

për përdorimin e ardhshëm të kampit në Prizren si Park Inovativ dhe Trajnues Kosovaro-Gjerman(ITP).

Ky studim i fizibilitetit²⁰ i cili u zhvillua në vitin 2018 i identifikoi pesë fusha:

- Inovacioni (Teknologjia dhe Ndërmarrësia);
- Promovimi i agrikulturës dhe përpunimit të ushqimit
- Industrinë kreative dhe kulturore (duke e përfshirë turizmin)

Po ashtu janë identifikuar edhe dy fusha të gërshetuara në vijim:

- Arsimimi dhe Trajnimi Profesional (ATP), Arsimimi Jo Formal, dhe
- Hulumtimi dhe Zhvillimi

Studimi i fizibilitetit thekson se vazhdojnë të mbijetojnë dobësi institucionale si mungesa e koordinimit të politikave dhe mungesa e iniciativave të qëndrueshme. Për më tepër, aktivitetet e transferimit të teknologjisë, si licencimi i teknologjisë dhe kompanitë spin-off, janë të pakta. Madje, bashkëpunimet me industrinë kanë prirje që të jenë të fragmentuara.

Më tej, studimi i fizibilitetit pretendon se përdorimi i teknologjisë informative nga ndërmarrjet ua shton atyre përparësinë konkurruese. Për më tepër, nuk është vetëm intensiteti i TI-së por edhe cilësia e përdorimit të TI-së që janë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e NVM-ve në Kosovë.

Qëllimi është që përmes Parkut Inovativ dhe Trajnues të bëhen sinergji në mes të edukimit dhe aftësimit profesional, shkencës dhe ndërmarrësisë duke dhënë kontribut për zhvillimin ekonomik dhe social në komunën e Prizrenit, në gjithë Kosovën dhe në pikëpamje perspektive edhe në rajon

5.5 Diskutimi i Kapitullit

Ekzistojnë disa burime me të dhëna dhe matje të përditësuara për sektorin e TI-së në Kosovë. Gjithsesi, këto të dhëna ende mbesin jo të plota dhe të fragmentuara. Është e vështirë që të krijohet një pamje e qartë e performancës së sektorit të TIK-ut dhe digjitalizimit të ekonomisë.

Ne kemi gjetur shumë pak prova për ekzistencën

²⁰Studimi i Fizibilitetit-Një koncept propozim për përdorimin e ardhshëm të kampit të KFOR-it në Prizren, Kosovë. Parku Inovativ dhe Trajnues Kosovë-Gjermani

e një sistemi funksional për raportimin e grupeve punuese për implementimin e detyrave specifike nga sipas Strategjisë së Kosovës për TI-në. Megjithatë, disa të dhëna janë të disponueshme në domenin publik e madje ose edhe në publikimet qeveritare, mirëpo nuk është e qartë se këto të dhëna përdoren për të mbështetur vendimmarrjen, investimet apo miratimin e politikave. Gjithsesi, strategjia për TI-në shpesh citohet në dokumentet e politikave publike si arsye për investime apo projekte të reja të caktuara.

Në studimin tonë, ne e kemi gjetur se pjesa më e madhe e të dhënave për performancën e sektorit të TIK-ut në Kosovë, janë në hulumtimet e bëra nga donatorët që janë duke zhvilluar studime të fizibilitetit për projekte të reja.

6. Vlerësimi i performancës së sektorit të TIK-ut në bazë të dëshmive ekzistuese

Në Kapitullin e 5, janë shfaqur masat kryesore dhe të dhënat e performancës për sektorin e TIK-ut. Sidoqoftë, është pothuajse e pamundur që të krijohet një pamje e qartë e sektorit të TIK-ut dhe investimet e TI-së në ekonomi.

Në këtë kapitull do të diskutojmë të dhënat e bëra publike në tentim për të krijuar një pamje më koherente për sektorin e TIK-ut. Diskutimi në këtë kapitull do të strukturohet rreth përpjekjeve për të promovuar sektorin e TIK-ut, investimet në infrastrukturën e TIK-ut, shpenzimet qeveritare dhe tregtinë ndërkombëtare në TIK.

Dy fushat në të cilat ka të dhëna kundërthënëse kanë të bëjnë me statistikën e punësimit dhe numrin e kompanive të TIK-ut në Kosovë. Ne ofrojmë një tentativë të parë për të krijuar më shumë qartësi por, kjo sipas të gjitha gjasave do të kërkonte analiza statistikore më të detajuara.

6.1 Promovimi i TIK-ut

Strategjia për TI-në e parasheh një numër të masave për të promovuar politikën për TIK-un, si krijimi i Ministrisë së TIK-ut dhe Komisionit Shtetëror për Transformimin Digjital si dhe promovimin e ekosistemit digjital për të përmirësuar ekosistemin digjital (industrinë e TI-së) dhe për të vendosur kushtet e nevojshme të kornizës për ndërmarrësi, inovacion dhe rritje të sektorit të TI-së. Gjendja aktuale tregon se ndonëse TIK-u ka potencial domethënës për rritje, politikën promovuese të TIK-ut janë goxha modeste në krahasim me vendet e tjera në rajon".²¹

6.2 Infrastruktura për rrjetet dhe shërbimet e TIK-ut

Në kuadër të Programit të Reformës Ekonomike (PRE), **zgjerimi i infrastrukturës relevante për rrjetet dhe shërbimet e TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik** është planifikuar nga QeK si një prej masave të reformave të PRE. Kjo masë synon që të përmirësojë qasjen dhe të përdor TIK-un përmes zgjerimit të infrastrukturës brezëgjere me shpejtësi të lartë, zhvillimi i aftësive të TIK-ut për Ekonominë Digjitale, furnizimi

dhe mbështetja e bizneseve digjitale për pjesëmarrje të plotë dhe për të maksimizuar dobitë e ekonomisë digjitale në një treg global. "Shpërndarja e infrastrukturës brezëgjere me shpejtësi të lartë do të kontribuojë për një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e inovacionit, modeleve të reja të bizneseve, prodhime dhe shërbime të reja dhe të përmirësuara, duke krijuar kështu konkurrencë dhe fleksibilitet në ekonomi. Përderisa, ofrimi i forcës punëtore me aftësi shumë të larta do të ndihmojë në shtytjen e sektorit të TIK-ut, rritjen e konkurrencës dhe shtimin e të ardhurave në ekonominë e vendit tonë".²² "Në bazë të SKZH-së, Agjendës Digjitale për Kosovën 2013-2020 dhe Strategjisë për TI-në, përmes kësaj mase synohet që të arrihet mbulimi (depërtimi) me infrastrukturë brezëgjere deri në 98% të amvisërive".²³ Kjo masë reformuese e PRE-së është planifikuar që të zbatohet kryesisht përmes programit të Bankës Botërore për Ekonominë Digjitale të Kosovës (KODE), fokusi duhet të jetë në zonat e pambuluara për të përmirësuar pozitën e Kosovës në krahasim me vendet e rajonit.

Komisioni Evropian e zhvillon një vlerësim të rregullt dhe e publikon një dokument pune (Raport i Vlerësimit) mbi zbatimin e masave të PRE-së. Raporti i Vlerësimit 2016 bën të ditur se "përkundër prezantimit të lehtësimeve në TVSH për pajisjet e TIK-ut, rritja substanciale në sektorin e TIK-ut kërkon furnizimin adekuat me inxhinier të arsimuar për kompjuter që tani mungon. Prandaj, zhvillimi i aftësive të TIK-ut për ekonominë digjitale është posaçërisht i rëndësishëm, por ndikimi i tij potencial në ekonomi është i kufizuar".²⁴

Zbatimi i masës së PRE-së "zgjerimi i infrastrukturës relevante për rrjetet dhe shërbimet e TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik" nuk ka pasur pothuajse fare zhvillim në zbatimin e saj. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2017 janë bartur sërish në vitin 2018. Në vitin 2019 dhe në vitin 2020, reforma tani përfshinë aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe mbështetjen e bizneseve digjitale por, disa prej këtyre veprimeve vazhdojnë të jenë mjaft të përgjithshme

²²Programi i Reformës Ekonomike 2016

²³Programi i Reformës Ekonomike (2017-2019)

²⁴Programi i Reformës Ekonomike (2016-2018) Vlerësimi i Komisionit 2016.

²¹Ekonominë Digjitale e Kosovës: Aftësitë për Punë, qershor 2016, BB.

dhe nuk përfshijnë ndonjë synim specifik.²⁵ Sërish, Raporti Vlerësues i KE 2019 pretendon se kjo masë është bartur nga PRE-të e kaluara dhe mbetet tërësisht relevante duke pasur parasysh depërtimin e broadband-it relativisht të ngadalshëm në Kosovë. Zbatimi ka përparuar në vitin 2018, gjegjësisht me 14 pilot projekte për zgjerimin e infrastrukturës për rrjetet e TIK-ut në zonat rurale dhe me marrëveshjen për një kredi prej 20,7 milionë EUR nga Banka Botërore e cila do të mundësojë investimet nga viti 2019. Masa përfshinë aktivitete që synojnë zhvillimin e infrastrukturës, mbështetjen e digjitalizimit të bizneseve dhe përmirësimin e aftësive elektronike në mesin e të rinjve. Sidoqoftë, ky aktivitet i mëvonshëm duket i kufizuar dhe mund të zhvillohet më tej dhe në nivele të ndryshme, nga shkollat fillore deri tek trajnimet profesionale, për të pasur ndikim. Për më tepër, në 3 vitet e fundit, vlerësimet e PRE-ve e kanë theksuar nevojën për të plotësuar investimet në infrastrukturë me

konkurrencë në mes të operatorëve dhe me pavarësi të rregullatorit; kjo nuk është adresuar ende.²⁶

6.3 Shpenzimet e qeverisë

Sipas Strategjisë për TI-në, segmenti më i rëndësishëm i tregut vendor është sektori publik. Të dhënat nga Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave tregojnë se në periudhën 2016-2018, institucionet publike i kanë shpenzuar rreth 2 milionë euro në blerjen e kompjuterëve, pajisjeve të TI-së, harduerit dhe softuerëve.

Të dhënat nga Raporti për Analizën e Llogarisë i Departamentit të Thesarit në lidhje me shpenzimet e institucioneve publike (qendrore dhe lokale) janë analizuar, grumbulluar dhe paraqitur në Tabela 2.

Tabela 2: Shpenzimet e qeverisë për TIK (2016-2018) në euro

	2016	2017	2018	Totali
Kompjuterë	111,857.74	169,485.37	188,470.03	469,813.14
Pajisje harduer	226,7162.96	30,465.24	816,925.15	3,114,553.35
Pajisjet e TI-së	446,6490.97	2,879,413.58	7,229,203.45	14,575,108.00
Softuerë	N/A	169,485.37	3,487,657.99	3,657,143.36

Burimi: Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave

Të dhënat tregojnë se me kalimin e kohës shpenzimet e qeverisë janë rritur në të gjitha kategoritë. Ka një rritje të dukshme në të gjitha prokurimet në mes të vitit 2017 dhe 2018.

viti 2016), eksporti i shërbimeve të TIK-ut është rritur vazhdimisht, siç edhe është paraqitur në tabelën në vijim:


6.4 Import and Export of ICT services

Në bazë të raporteve vlerësuese të KE-së për PRE, TIK-u ka filluar të luaj një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në rritjen ekonomike të Kosovës. Sipas të dhënave nga barometri i TI-së i Kosovës, përveç se në vitin 2017 (një rënie prej 17% nga

²⁵Programi i Reformës Ekonomike (2018-2020) Vlerësimi i Komisionit 2018.

²⁶Programi i Reformës Ekonomike* (2019-2021) Vlerësimi i Komisionit 2019.

Figura 3: Përqindja e kompanive kosovare që eksportojnë shërbime të TIK-ut




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Sipas Raportit Vlerësues të KE mbi zbatimin e PRE-së 2019-2021, "sektori i TIK-ut prapë e ka mbyllur vitin 2018 me bilanc negativ tregtar. Sidoqoftë, nuk është rritja e eksporteve në vet sektorin e TIK-ut që do të çojë në rritje të qëndrueshme ekonomike por, aplikimi i zgjidhjeve digjitale në ekonominë më të gjerë (p.sh. furnizimi me energji elektrike, financa, agrikulturë). Rritja organike e eksportit në sektorin e TIK-ut mundet po ashtu të ndihmojë në krijimin e një përparësi shtesë në modelin e biznesit të

ekonomisë së Kosovës, dhe që të kontribuojë në rritjen ekonomike²⁷".

Të dhënat e publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për Eksportimin dhe Importimin e Shërbimeve të TIK-ut janë përdorur për të llogaritur vlerën e shërbimeve të importuara dhe eksportuara të TIK-ut për periudhën 2007-2018. Rezultatet janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

Figura 4: Importimi dhe eksportimi i shërbimeve të TIK-ut




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

²⁷Raporti Vlerësues për zbatimin e PRE 2019-2021.

Në përgjithësi, mund të shihet se eksportimi i shërbimeve të TIK-ut ka rënë nga 96,9 milionë euro në vitin 2011 në diku 55,8 milionë në vitin 2018.²⁸ Në të njëjtën kohë, importimi i shërbimeve të TIK-ut është rritur nga 20,1 milionë euro në 61,1 milionë euro. Bilanci i shërbimeve të TIK-ut është negativ në dy vitet e fundit (-4,7 milionë euro në vitin 2017 dhe rritet në -5,3 milionë euro në vitin 2018). Tendenca e njëjtë vërehet në të dhënat e Bankës Botërore (Treguesit e Zhvillimit Botëror).

Duke qenë se shërbimet e TIK-ut përbëhen nga tri nënkategori kryesore (nën-sektor) është e rëndësishme që të analizohet më tej pesha e secilit nën-sektor në totalin e eksportimit të shërbimeve të TIK-ut. Prandaj, grafiku në vijim e paraqet eksportimin nga secili nën-sektor nga vitet 2007-2018:

Figura 5: Eksportimi i shërbimeve të TIK-ut sipas nën-sektorëve



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)


Mund të shihet se shërbimet e telekomunikimit janë dominuese. Prandaj, trendi negativ i eksportimit të shërbimeve të TIK-ut është vetë-shpjegues për shkak të rënies domethënëse të shërbimeve të telekomunikimit. Në anën tjetër, mund të vërejmë një rritje në eksportimin e shërbimeve kompjuterike nga 1,3 milionë euro në vitin 2013, për të arritur në 21,4 milionë euro në vitin 2018. Të dhënat për eksportimin e shërbimeve kompjuterike (për vitet 2007-2012) dhe shërbimet informative (2014-2016) janë në dispozicion në grupet e të dhënave të BQK-së.

TIK-ut, shërbimet kompjuterike duhet të bëhen më të rëndësishme për këtë analizë. Prandaj, eksportimi dhe importimi i shërbimeve kompjuterike janë krahasuar në figurën në vijim, dhe është e qartë që eksportimi i shërbimeve kompjuterike është rritur vazhdimisht nga viti 2013 (nga më pak se 2 milionë euro) deri në vitin 2018 (në më shumë se 21 milionë euro).

Në bazë të metodologjisë për Bilancin e Pagesave të përdorur nga BQK-ja dhe BB-ja për përshkrimin e tri kategorive të shërbimeve të

²⁸Supozohet se rënia e eksportimit të shërbimeve të TIK-ut ka ndodhur kryesisht për shkak të rënies së shpejtë të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në sektorin e telekomunikacionit. Thirrjet hyrëse me zë, kanë rënë me shpejtësi pas paraqitjes së shërbimeve "Over the Top - OTT" si Viber, WhatsApp, etj.

Figura 6: Importimi kundër eksportimit të shërbimeve të TIK-ut



6.5 Importing of ICT equipment

Në bazë të të dhënave të publikuara nga Doganat e Kosovës, vlera e pajisjeve të TIK-ut²⁹ të importuara për periudhën 2015 deri në shtator

të vitit 2019 arrin në 79 milionë euro (Shih Tabela 3). Këto të dhëna bazohen në Kodin Tarifor dhe sipas të gjitha gjasave nuk e përfaqëson sa duhet importin total.

Tabela 3: Importimi i pajisjeve të TIK-ut nga viti 2015 deri në shtator të vitit 2019.

Viti	2015	2016	2017	2018	2019 (shtator)	TOTALI
Vlera e pajisjeve të importuara të TIK-ut pa TVSH	354,545.77	567,605.45	291,988.04	612,962.32	271,420.78	2,098,522.36
Vlera e pajisjeve të importuara të TIK-ut me TVSH	8,623,057.93	13,542,419.90	18,769,675.98	22,002,447.24	13,558,428.82	76,496,029.87
TOTALI	8,977,603.70	14,110,025.35	19,061,664.02	22,615,409.56	13,829,849.60	78,594,552.23

Burimi: Dogana e Kosovës³⁰

Këto të dhëna të tarifës tregojnë një rritje të vazhdueshme të importimit të TIK-ut, e cila mund të shihet si një tregues përfaqësues për digjitalizimin e tërë ekonomisë.

6.6 Trendet e punësimit

Statistikat zyrtare të nxjerra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se punësimi në TIK pothuajse është dyfishuar gjatë katër viteve


²⁷Kreu 8471- Makinat Automatikë për përpunimin e të dhënave dhe njësitë e tyre; lexuesit magnetik ose optik, makinat për transkriptimin e të dhënave në të dhëna të medieve në formë të koduar dhe makinat për përpunimin e të dhënave të tilla, të paspecifikuara apo përfshira diku tjetër. <https://dogana.rks-gov.net/tarik/>

²⁸<https://dogana.rks-gov.net/per-doganen/statistikat-dhe-arritjet/bilanci-tregtare-bazuar-ne-tarife/>

të fundit. Në mënyrë të jashtëzakonshme, punësimi i femrave tregon një rritje të madhe në vitin 2019, pas mbetjes prapa punësimit të meshkujve për disa vite me radhë.

Tabela në vijim është nxjerrë nga Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë (2016, 2017, 2018 dhe 2019) dhe ajo e përfaqëson përqindjen e punësimit në sektorin e TIK-ut si total i punësimit:

Figura 7: Punëtorët në sektorin e TIK-ut



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë, 2016, 2017, 2018 dhe 2019

Të dhënat në Tabelën 6 tregojnë një trend në rritje të punësimit në sektorin e TIK-ut, i cili rrjedhimisht është duke u bërë një sektor i rëndësishëm dhe potencial për punësimin në Kosovë. Këto të dhëna janë në kontrast me statistikat e Programit të Reformës Ekonomike 2019-2021 i cili e ofron një vlerësim shumë më të ulët të punëtorëve në sektorin e TIK-ut. Sipas PRE (2019-2021) vlerësohet se në fund të vitit 2018 ishin rreth 2000 të punësuar në sektorin e TIK-ut, apo më pak se 1% e tërë fuqisë punëtore në krahasim me mesataren prej 3,7% në BE.

MTI-ja vlerëson se 85,3% e fuqisë punëtore në Kosovë ishin të punësuar në sektorin e shërbimeve në vitin 2018. Nga kjo përqindje, sektori i TIK-ut vlerësohet të jetë 3,5%³¹.

Kjo rritje e punësimit i atribuohet rritjes së numrit të kompanive, dhe sipas Barometrit të TI-së të STIKK të vitit 2018, rritjes së numrit mesatar të punëtorëve për kompani. Ky numër është rritur nga mesatarisht 13 punëtor në vitin 2016, në 16 në vitin 2017 dhe sërish në 21

punëtorë në vitin 2018³². Ky numër duhet të trajtohet me kujdes pasi që numri i të anketuarve ishte i vogël.

Në intervistat e tona, u përmend shpesh një treg i punëtorëve të pavarur (frelancer) "me aftësi të larta" në Kosovë. Sidoqoftë, këta punëtorë të pavarur nuk paraqiten në statistikat zyrtare. Punëtorët e pavarur mund të punojnë si kodues, programues, këshilltar dhe ekspert teknik të pavarur, apo si nën-kontraktor për kompanitë e tjera.

6.7 Numri i kompanive të TIK-ut në Kosovë

Është e vështirë që të krijohet një pamje e saktë e madhësisë së sektorit të TIK-ut në Kosovë. Statistikat zyrtare shtrihen nga vlerësime prej 220 deri në më shumë se 7000. Ne arritëm që të përcaktonim se sipas të gjitha gjasave numri 220 ishte nxjerrë nga statistikat zyrtare të Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës të vitit 2013³³.

Tabela 4: Bizneset e TIK-ut të regjistruara në Kosovë

Viti	2010	2011	2012	2013
Bizneset e TIK-ut	188	165	219	220

Burimi: Baza e të dhënave të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

³¹Përmbledhja mbi Tregtinë në Shërbime, 2018, MTI

³²Barometri i TI-së i Kosovës 2018, STIKK

³³Profili i sektorit të TIK-ut, 2014, MTI

Në Strategjinë për TI-në, STIKK pretendon se janë diku rreth 120 kompani të TI-së.³⁴ Numër i njëjtë është raportuar në PRE 2019-2021 "nga 571 bizneset e regjistruara që e kanë TIK-un si aktivitetin e tyre primar, vetëm 120 prej tyre janë biznese që ofrojnë shërbime për produktet e TIK-ut, përderisa të tjerat janë biznese shitëse e servisuere të harduerit³⁵".

Në të dhënat e nxjerra rishtas mbi platformën "the Future Workplace"³⁶, numri i bizneseve të TIK-ut të regjistruara është 7,762³⁷. Më tej, të dhënat për kompanitë e TIK-ut kategorizohen sipas aktivitetit në të cilin janë të përfshira bizneset e TIK-ut, si:

- Publikimi i Lojërave Kompjuterike
- Aktivitete të Programit Kompjuterik
- Aktivitete të Konsulencës Kompjuterike
- Aktivitete të Menaxhimit të Objekteve Kompjuterike
 - Shërbime të Teknologjisë Informative dhe Kompjuterike
 - Aktivitete të Telekomunikimeve me Kabllo
 - Aktivitete të Telekomunikimeve pa Kabllo
 - Aktivitete të Telekomunikimeve Satelitore
 - Aktivitete të Telekomunikimeve të Tjera
 - Publikim të Softuerëve të Tjerë
 - Përpunim i të Dhënave: hosting dhe aktivitete të tjera
 - Aktivitete të Telekomunikimeve me Kabllo
 - Aktivitete të Telekomunikimeve pa Kabllo
 - Aktivitete të Telekomunikimeve Satelitore
 - Aktivitete të Telekomunikimeve të Tjera
 - Publikim të Softuerëve të Tjerë
 - Përpunim i të Dhënave: hosting dhe aktivitete të ndërlidhura

Siç është diskutuar më sipër në pjesën 5, numri i bizneseve të TIK-ut të raportuara në këtë platformë është shumë më i lartë se sa ai që raportohet nga burimet e tjera.

6.8 Diskutimi i Kapitullit

Zgjerimi i infrastrukturës brezëgjere me shpejtësi të lartë për rrjetet dhe shërbimet e TIK-ut si dhe zhvillimi i aftësive për TIK-un pasi që Ekonomia Digjitale do të jetë një masë kyçe në kuadër të politikave të Qeverisë si PRE. Sidoqoftë, zbatimi i një politike të tillë ka shfaqur shumë

³⁴Strategjia e Kosovës për TI

³⁵ERP 2019-2021.

³⁶<https://thefutureworkplace.org/en/stats>

³⁷Shqyrtimi më i afërt i të dhënave tregon se këto të dhëna mund të kenë nevojë për pastrim të mëtejshëm. Në emrat e kompanive janë të përfshirë kontraktorët elektrik, kompanitë e tekstilit dhe të tjera të cilat në bazë të emrave të tyre kanë pak gjasa që të jenë kompani të TI-së.

pak përparim gjatë vitit 2018 kur disa pilot projekte u zbatuan për të zgjeruar infrastrukturën e rrjetit të TIK-ut në zonat rurale. Më tej, pritjet që projekti KODE do të jetë ndërhyrësi kryesor në zhvillimin e infrastrukturës së TIK-ut, mundësimin e bizneseve dhe rritjen e aftësive për TIK-un tek të rinjtë.

Përkufizimi i shërbimeve të TIK-ut është shumë i gjerë dhe ai përfshin një sërë aktivitetesh në secilin prej nën-sektorëve si informacioni, komunikimi dhe teknologjia. Ky përkufizim i gjerë e ka një ndikim domethënës në paraqitjen e të dhënave në lidhje me tregtinë e shërbimeve të TIK-ut.

Bilanci i tregtimit të shërbimeve të TIK-ut është negativ gjatë viteve të fundit, me rënie të eksportit dhe rritje të lehtë në importimin e shërbimeve të TIK-ut. Shikimi më i detajuar zbuloi se në kuadër të sektorit të TIK-ut, shërbimet e komunikimit e kishin pjesën më të madhe të shërbimeve të eksportuara të TIK-ut, prandaj, trendi negativ i shërbimeve të tregtuara të TIK-ut mund t'i atribuohet rënies në shërbimet e komunikimit. Në anën tjetër, eksportimi i shërbimeve kompjuterike, të cilat janë në zemër të shërbimeve të kompanive të TI-së, është rritur dukshëm gjatë pesë viteve të fundit duke rezultuar me bilanc tregtar pozitiv.

Dy fushat në të cilat ka të dhëna kundërthënëse kanë të bëjnë me statistikat e sakta të punësimit dhe numrin e kompanive të TIK-ut në Kosovë. Kundërthënia vjen kryesisht nga përkufizimi dhe shtrirja e sektorit të TIK-ut. STIKK kryesisht raporton për të dhënat që kanë të bëjnë me kompanitë e TI-së. Prandaj, numri i kompanive të TIK-ut dhe totalit të punëtorëve në këto kompani është më i vogël. Në anën tjetër, të dhënat e raportuara nga Agjencia e Statistikave dhe regjistri i bizneseve i MTI-së, ku shtrirja dhe përkufizimi i TIK-ut janë më të gjera, dhe numri i bizneseve të TIK-ut dhe punëtorëve në sektorin e TIK-ut është më i madh.

Në këtë raport, ne ofrojmë një tentativë të parë për të krijuar më shumë qartësi por, kjo sipas të gjitha gjasave do të kërkonte analiza statistikore më të detajuara. më tej nevojitet një përkufizim i qartë i aktiviteteve që i përkasin sektorit të TIK-ut dhe miratimin e një metodologjie të përbashkët për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për sektorin e TIK-ut.

7. Rekomandimet

Sektori TIK vepron si përcaktues kryesor në promovimin e rritjes, inovacionit dhe fuqisë konkurruese në ekonomi. Edhe në Kosovë sektori i Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit (TIK-ut) shihet si një sektor atraktiv për rritje ekonomike, promovimin e eksportit, për të krijuar vende pune për rininë.

Në hulumtimin tonë ne kemi gjetur se sektori i TIK-ut në Kosovë është duke u rritur, gjithashtu edhe kërkesa për shërbime të TIK-ut si në sektorin publik dhe privat po ashtu është duke u rritur. Përkundër faktit që ekzistojnë disa burime me të dhëna dhe matje të përditësuara për sektorin e TIK në Kosovë, gjithsesi, këto të dhëna ende mbesin jo të plota dhe të fragmentuara. Është e vështirë që të krijohet një pamje e qartë e performancës së sektorit të TIK-ut dhe digjitalizimit të ekonomisë.

Duke pasur parasysh kontekstin, IETL në vazhdim, propozon politikat rekomanduese:

Përmirësimi i të dhënave statistikore

Qeveria e Kosovës duhet të orientohet në përmirësimin e të dhënave statistikore për të siguruar informacione për krahasimin dhe monitorimin e zhvillimeve në sektorin e TIK-ut për tu përdorur për qëllime të propozimit të politikave të reja. Ky hap duhet të adresohet përmes:

- Përmirësimi i të dhënave statistikore për TIK-un nga burimet e ndryshme (Administrata Tatimore, Doganat, Banka Qendrore, MTI, MASHT, dhe të tjerë).
- Agjencia e Statistikave të Kosovës të ofrojë të dhëna të cilësisë më të lartë (numri i punëtorëve, numri i kompanive).
- Përmirësimi i kualitetit të Barometrit të TI-së të STIKK, e cila u vlerësua të jetë vegla më e rëndësishme për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë së Kosovës për TI si dhe ofrimin e informacioneve mbi industrinë e TIK-ut.

Përditësimi i Strategjisë Kombëtare për TI-në

Nga gjetjet e hulumtimit tonë vlerësojmë se që nga periudha e hartimit dhe aprovimit të Strategjisë Kombëtare për TI-në është arritur përparim në zhvillimin e sektorit të TIK. Edhe pse në dokumentin strategjik janë definuar instrumentet (plani operativ i detajuar) për implementimin efektiv të strategjisë, megjithatë procesit i Monitorimit dhe Vlerësimit për Strategjinë e TI nuk ka

funksionuar duke pasur kufizime në resurse financiare dhe në staf. Gjithashtu për shkak të dinamikës së industrisë ne rekomandojmë përditësimin e Strategjisë Kombëtare për TI-në i cili duhet të përfshijë:

- Rishikimin gjithëpërfshirës të Strategjisë së Kosovës për TI-në
- Inicimin, zhvillimin dhe miratimin e strategjisë së re për TI-në
- Strategjia e re më pak e detajuar por me qëllime më realiste
- Monitorim dhe vlerësim më i mirë dhe më funksional i strategjisë së re për TI-në
- Strategjia e re për TI-në nuk duhet që sërish të bazohet në tërësi në fondet e donatorëve ndaj QeK duhet të tregojë më shumë përkushtim kundrejt financimit.

Koordinim më i mirë i QeK me organizatat donatore ndërkombëtare

Qeveria duhet të bëhet më pro-aktive, të vendosë agjendën për projektet e donatorëve e sidomos duhet të marrë një rol më të madh në koordinimin e organizatave donatore ndërkombëtare që ofrojnë financim fillestar për biznese të reja. Në vend të skemave periodike të granteve të publikuara nga donatorë individualë që aplikojnë kriteret e ndryshueshme, organizatat donatore duhet të nxiten të bashkojnë fondet e tyre në një skemë publike të financimit që financon bizneset e reja sipas planeve dhe strategjive për zhvillimin sektorial dhe kombëtar. Një qasje e tillë do të lejonte një qëndrueshmëri më të madhe të skemave të financimit dhe disponueshmërinë më të madhe të financimit për këto biznese.

Koordinimi me i mirë i sektorit të IT

Në përgjithësi, sektorit i TIK në Kosovë ka nevojë të koordinohet më mirë. Qeveria duhet të ketë:

- Rol dhe përgjegjësi më të qarta në çështjet që kanë të bëjnë me TIK-un në kuadër të Ministrive/ Departamenteve/ Agjencive/ Rregullatorëve, etj.
- QeK duhet të ofrojë më shumë mbështetje (grante, hapësira për zyra për kompanitë e sapo formuara, politika, etj.) për kompanitë e TIK-ut.
- Zhvillimin e tregut vendor- qeveria mundet të hap mundësi shtesë për kompanitë kosovare të IT-së në tregun vendor. Globalisht, qeveritë janë shpesh blerësit dhe përdoruesit më të sofistikuar të TI-së dhe mund të shërbejnë si impuls

kritik në zhvillimin e dinamikës dhe aftësive në tregun vendore të TI-së.

- Pasi që shumë biznese të reja kërkojnë programim/kodim si pjesë e zhvillimit fillestar të biznesit, do të duhej të krijohen skema mbështetëse që do të mbulonin koston e zhvillimit (programuesve). Skema të tilla ndoshta do të mund të mbështesnin idetë e biznesit që janë aktualisht të lëna anash për shkak të pamundësisë për të financuar fazën e zhvillimit. Si i tillë, financimi për kërkime dhe zhvillim do të duhej të inkurajonte zhvilluesit entuziastë që të ndërtonjë së paku modelet demonstruese që mund të ju sjellin atyre financim komercial. Një gjë e tillë do të rriste mundësinë që bizneset fillestare TIK me rritje të shpejtë të pranojnë financim në fazat e hershme të zhvillimit.

Përmirësimi i arsimimit në TI:

- Arsimimi dhe trajnimi resurseve njerëzore janë përcaktues kyç të konkurrueshmërisë së industrisë kosovare të TI-së.

- Përmirësimi i vazhdueshëm të arsimimit mbi TI në Kosovë në nivele primare, sekondare dhe veçanërisht ato terciare.

- Theks të veçantë duhet vënë në bashkërendimin e kurrikulës së TI-së me nevojat e caktuara të sektorit privat dhe në nxitjen e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet universiteteve dhe industrisë së TI-së.

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe industrisë së TI-së (Pjesëmarrja e kompanive TIK në hartimin e kurrikulave, ose duke qenë pjesë e trupit mbikëqyrës të ofruesit të Sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP).

- Aktivitetet jashtë-shkollore si klube të shkencës, panairë dhe konkurse për shkolla fillore dhe të mesme do të duhej të organizohen për të promovuar angazhimin në shkencë. Në nivelet më të larta të arsimit, praktikat e tilla do të duhej të intensifikohen për të promovuar konkurrencën e ideve dhe inovacionit.

- Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie përmes përdorimit të kompjuterëve dhe software-ve në mënyrë produktive, shfrytëzimin e internetit dhe përdorimin e rrjeteve kompjuterike për qëllime të mësimdhënies dhe të nxënies.

SHTOJCA

Shtojca 1: Projektet e donatorëve në mbështetje të TIK-ut në Kosovë

Tabela 5: Lista e projekteve nga Platforma për Menaxhimin e Ndhmës

Titulli	Agjencia Donatore	Vlera në EUR
Konferenca Rajonale për TI - KosICT 2013	Norvegjia	4,995.25
Promovimi i TIK-ut për vajzat në arsimimin dytësor	Ambasada Mbretërore e Norvegjisë në Prishtinë	240,310.79
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - STRATEGJIA PËR TIK-un	Norvegjia	39,077.16
Kosovo ICT Inovation HUB (NYJA për Inovacion për TIK-un në Kosovë) - Koncept Studim	Norvegjia	35,516.29
IPA 2016/400-767 - Trajnim dhe arsimim me aftësi tregu për TIK-un për punësim dhe vetëpunësim në Kosovë	Zyra e Bashkimit Evropian	177,146
IPA 2013 - Furnizimi më pajisje për TIK, pajisje dhe materiale për shpenzim për shkolla dhe institucione arsimore - LOTI 2	Komisioni Evropian	554,720
IPA 2013 - Furnizimi më pajisje për TIK, pajisje dhe materiale për shpenzim për shkolla dhe institucione arsimore - LOTI 1	Komisioni Evropian	174,471
IPA 2013 - TIK në Arsim - Faza II Kontrata për Furnizim	Zyra e Bashkimit Evropian	N/A
IPA 2013 - TIK në Arsim - Faza II Kontrata për Shërbim	Zyra e Bashkimit Evropian	N/A
IPA 2013 - BE-TIK dhe të mësuarit elektronik në Projektin për Arsim Faza 2	Zyra e Bashkimit Evropian	901,000
IPA 2011 - Furnizime dhe pajisje për Shkolla në tërë Kosovën - Loti 2 Pajisje për TIK	Zyra e Bashkimit Evropian	
Menaxhimi i Informacionit dhe TIK-u i nevojshëm për statistikat zyrtare (FY2010)	Qeveria e Japonisë	11,257.93
Menaxhimi i Informacionit dhe TIK-u i nevojshëm për statistikat zyrtare	Qeveria e Japonisë	11,257.93
TIK për përmirësimin e kapaciteteve dhe shërbimeve të qeverisë; sistemit informues, siguria dhe strategjia (FY2015)	Qeveria e Japonisë	10,292.60

Title	Agjencia Donatore	Vlera në EUR
TIK për Përmirësimin e Kapaciteteve dhe Shërbimeve të Qeverisë (FY2016)	Qeveria e Japonisë	10,292.60
Shoqata e TIK-ut në Kosovë	Norvegjia	228,145.07
Zhvillimi i kapaciteteve profesionale në fakultetet e Edukimit në Prizren dhe në Mitrovicë përmes TIK-ut si një mjet mësimor	Agjencia Austriake për Zhvillim	319,831
Ndërtimi i Kapaciteteve për Planifikimin e Projektit për TIK (FY2017)	Qeveria e Japonisë	20,585.21
Ndërtimi i Kapaciteteve për Planifikimin e Projektit për TIK (FY2016)	Qeveria e Japonisë	10,292.60
Aplikimi i Inovacioneve të TIK-ut për Modernizimin e Sistemeve Zyrtare të Statistikave (FY2016)	Qeveria e Japonisë	10,292.60
2018/402-163 - Rritja e TVSH-së në TIK me 'New Cloud Solutions'(Zgjidhjet e Reja në Shërbimet Cloud), Kontraktimi dhe Certifikimet Ndërkombëtare	Zyra e Bashkimit Evropian	75,088
Mbështetje për SIMA (Sistemin e Informacionit për Menaxhimin e Arsimit) - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë mbi Treguesit e Arsimit, Monitorimin dhe raportimin, planifikimin e bazuar në dëshmi.	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara	29,377.20
Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Zbatimin e Ligjit	Departamenti i Shtetit të Bashkuara	3,335,062.62
KPA Mbështetje për Sistemin Informues	Norvegjia	11,870.28
KPA Sistemi Informues	Norvegjia	16,518
Krijimi i sistemit informues për burimet tokësore për shfrytëzim të qëndrueshëm të tokës	Organizata për Ushqim dhe Agrikulturë	27,693.81
PEU CSSF YUP 0003009 / Ndihmë në krijimin e Zyrës së Zhvillimit dhe Këshillimit të Biznesit brenda Qendrës së Inovacionit Jakova për të rritur zhvillimin ekonomik rajonal të Komunës së Gjakovës dhe krijuar mundësi të reja të biznesit	Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore	26,916.23
Mbështetje thelbësore për Qendrën Inovative të Kosovës	Suedia	1,120,490.03
Nxitja e Inovacionit të Rinisë në Kosovë	Austria, Zyra e Bashkimit Evropian	1,164,155.45
IPA 2011 -Mbikëqyrje e Mëtejme e Kontratës për Furnizim me TI (Sistemi i Informacionit të Policisë së Kosovës)	Zyra e Bashkimit Evropian	12,168

Titulli	Agjencia Donatore	Vlera në EUR
IPA 2010 -Mbikëqyrje e Kontratës për Furnizim me TI - Sistemi i Informacionit të Policisë së Kosovës	Zyra e Bashkimit Evropian	58,640
Softuerë për KPA	Norvegjia	2,700
Kontraktimi dhe Dituritë për Transferim për Zhvillimin e Zgjidhjeve për Softuerë	Agjencia Austriake për Zhvillim	116,000
IPA 2014 - Furnizimi dhe mirëmbajtja e softuerëve për monitorimin e cilësisë së ajrit	Zyra e Bashkimit Evropian	19,990
IPA 2007 - BMS I - Licencë dhe softuer kompjuterik	Zyra e Bashkimit Evropian	6,225

Tabela 6: Lista e Projekteve nga burimet e tjera

Donatorët	Projekti	Shuma
Ambasada Norvegjeze	Mbështetja e sektorit të TIK-ut	14 Milionë euro
Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar	Krijimi i punësimit përmes promovimit të eksportit	€2.5 - 3M
Ambasada e Finlandës/FICORA	Shkëmbim nga rregullatori në rregullator	N/A
EBRD	Ndërtimi i Kapaciteteve të Sektorit të TIK-ut	€150,000
USAID	FUQIZIMI i Sektorit Privat	N/A
Banka Botërore	Ekonomia Digjitale e Kosovës (KODE)	€20,700,000 (kredi)
Ambasada e Suedisë/SIDA	Mbështetje buxhetore për QIK; Kontribuues për FUQIZIMIN e Sektorit Privat	N/A
BE	Përmirësimi i Konkurrencës së Sektorit të TIK-ut në Kosovë, Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) II (2014-2020)	€3M
Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim	Përmirësimi i Punësimit të të Rinjve	N/A
Agjenda Digjitale Evropiane për Ballkanin Perëndimor	Nën Kornizën e Investimit për Ballkanin Perëndimor (WBIF)	€30 milionë në grante të BE-së për infrastrukturën broadband në vendet e Ballkanit Perëndimor

